

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7643 E enjte 6 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ALBANO ZHAPAJ

Lulzim Basha dhe zjarri (ar)mik



Shqiptarët sot e pesë vjet po përballen me pasiguri të paprecedentë që nga koha e regjimit komunist, pasiguri kjo që u detyrohet efekteve të qeverisjes ...
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

Gjithçka për konsumin

3.3 miliardë lekë të reja ose mbi 26.5 milionë euro shpërblim fundviti për të 670 mijë pensionistët tanë është lajm i mirë. Krahas gëzimit afatshkurtër të shtresës ...
Vijon në faqen 21



Gazetarja e "News 24" flet pas atentatit

Klodiana Lala: Të qëllosh drejt fëmijëve, barbari dhe akt burracak

"Kam dyshime për shkak të detyrës. Para dy vitesh më kërcënuan, policia më dha mbrojtje"

TIRANE - Banesa e prindërve të gazetares së "News 24", Klodiana Lala u sulmua me armë gjatë orëve të para të mëngjesit të 30 gushtit, në rrugën "Shkëndija" në fshatin Bruk në Tiranë. Kur kanë kaluar gjashtë ditë nga sulmi në banesën ku në momentin e ngjarjes ndodheshin edhe dy vajzat e saj të mitura, gazetarja Klodiana ...
Në faqen 8

KREU I SHOQATES "PRONESI ME DREJTESI": STRASBURGU, SINJALE POZITIVE

PRONARET: KOMPENSIMI, FATURA 4.9 MILIARDE EURO

Myrshit Vorpsi: Presim plotësimin e kuorumit të Gjykatës Kushtetuese. Agjencia e Pronave na llogariti 620 milionë euro, por tokat vlejnë 9 herë më shumë



(Në foto) Kreu i shoqatës "Pronësi me Drejtësi", Myrshit Vorpsi

DIALOGU KOSOVE-SERBI



Korrigjimi i kufijve, Thaçi: Me Vuçiç nuk diskutoj për Mitrovicën

Në faqen 11

PD, letër Gramoz Ruçit: Të shkarkohet Xhafaj-Veliu, penguan hetimin e Tahirit

Bojkot Kuvendit, opozita mblidhet në Elbasan

Rama premtion libra falas për fëmijët në nevojë: Deri në klasën e 9

Nga VALENTINA MADANI

Kuvendi i Shqipërisë do të mblidhet sot në seancë plenare, në të cilën është futur për votim edhe ligji i shumëdebatuar për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që kërkon votim me shumë prej



3/5. Në rendin e ditës së Kuvendit janë edhe ndryshimet në Kodin Rrugor, që po ashtu kërkojnë votim me shumicë prej 3/5. Gjithashtu, në rend dite është edhe akti normativ i buxhetit të shtetit, por opozita do ta ...
Në faqen 2

KAPET AUTORI

Sherr fëmijësh, vritet me thikë 13-vjeçari në Fushë-Mamurras

Në faqen 9

REGJISTRIMI I PRONAVE

Kreu i Hipotekës: Të gjitha dosjet e prapambetura zgjidhen këtë muaj

Në faqen 7

2-VJETORI I SHENJTERIMIT

Muzeu Kombëtar hap ekspozitën me sendet personale të Nënë Terezës

Në faqen 19

KRIMI

Ekzekutohet në Spanjë 43-vjeçari, dyshimi: Pazare ose hakmarrje

Në faqen 9

SITUATA POLITIKE PËRPLASJA

Ligji i debatuar "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", në parlament

Opozita bojkoton Kuvendin, sot zhvendoset në Elbasan

Në rend dite, akti normativ i buxhetit të shtetit

Valentina Madani

Kuvendi i Shqipërisë do të mbledhet sot në seancë plenare, në të cilën është futur për votim edhe ligji i shumëdebatuar për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që kërkon votim me shumë prej 3/5. Në rendin e ditës së Kuvendit janë edhe ndryshimet në Kodin Rrugor, që po ashtu kërkojnë votim me shumicë prej 3/5. Gjithashtu, në rend dite është edhe akti normativ i buxhetit të shtetit, por opozita do ta bojkotojë sërish seancën e sotme plenare. Pas Shkodrës, opozita do të mbledhet në qytetin e Elbasanit. Burimet bëjnë të ditur se takimi do të zhvillohet në orën 10:00. Në momentin kur do mbledhet Kuvendi, deputetët e opozitës do shkojnë në Elbasan për të mbajtur atje paralelisht një tryezë diskutimi, sërish për çështjet e kriminalitetit. Të hënën opozita u mbledh në Shkodër nga ku ngritën shqetësime për ngjarjet e fundit kriminale atje, ndërsa paralelisht zhvillohet punimet seanca e Kuvendit në Tiranë, duke nisur sesionin e ri parlamentar. Opozita akuzon mahorancën se ngjarjet e fundit kriminale janë rrjedhojë e kapjes së qeverisë dhe Policisë së Shtetit nga krimi. Opozitarët kanë vendosur të bojkotojnë për të dytën herë radhazi seancën plenare, për t'u zhvendosur në një tjetër qytet, pas Shkodrës në Elbasan, duke e vlerësuar këtë të fundit si qytetin e dytë në vend ku sipas tyre fshihen lidhjet e forta krim-geveri. Nga veriu i vendit, pak ditë më parë Lulzim Basha paralajmëroi se glirimi i qeverisë nga krimi do të jetë prioriteti i opozitës në këtë sesion të ri, ndërsa foli për një platformë politike, që parashikohet të përgatitet nga opozita për t'i dhënë vendit siguri dhe rend. Kryedemokratit nuk foli për bojkot, por aleati i saj LSI konfirmoi për mediat mar-

rëdhënie të kushtëzuar me parlamentin. Të enjten socialistët prisnin kolegët e tyre opozitarë për të miratuar bashkë ndryshimet në ligjin

për statutin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që i hapin rrugë zhblokimit të shkollës së magistraturës, e cila do të vijojë të mbesë e bllokuar për

sa kohë opozita ka vendosur që të mos ketë normalitet në Kuvend, pa çliruar më parë sipas saj, qeverisjen e vendit nga krimi.

TAKIMI

Pas Shkodrës, opozita do të mbledhet në qytetin e Elbasanit. Burimet bëjnë të ditur se takimi do të zhvillohet në orën 10:00. Në momentin kur do mbledhet Kuvendi, deputetët e opozitës do shkojnë në Elbasan për të mbajtur atje paralelisht një tryezë diskutimi, sërish për çështjet e kriminalitetit.



Opozita e bashkuar

Kreu i PD zbardh skemën e pasurimit të krimit

Basha: Me Ramën në qeveri pasurohen oligarkët e falimentojnë të ndershmit

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzon kryeministrin Edi Rama dhe qeverisjen e tij se kanë lidhje të forta me krimin. Sipas tij, mbështetja e qeverisë ndaj krimit të organizuar dhe oligarkëve bëhet në dëm të bizneseve të ndershme. Nëpërmjet një skeme video të publikuar në llogarinë e tij në "Facebook", Basha tregoi se është rritur ndjeshëm numri i bizneseve që kanë shpallur falimentin, krahasuar me një vit më parë. Sipas shifrave të publikuara nga Basha, nga 6140 biznese të mbyllura në periudhën janar-gusht 2017, kjo shifër ka shkuar në 9260 në të njëjtën periudhë të vitit aktual, një rritje me rreth 30%. Në video me germa kapitale dhe me sfond të zi shkruhet: "Me Edi Ramën në qeveri, krimi



dhe oligarkët pasurohen, bizneset e ndershme falimentojnë". Partia Demokratike vijon përgatitjen e terrenit për atë që e quan aksion radikal kundër qeverisë "Rama". Lideri i opozitës paralajmëroi nga Shkodra: "Ajo që ka rëndësi është shkalla e mobilizimit me të cilën ne si PD, në nivelin e lagjeve, blloqeve, shtëpive e

SHIFRAT

Sipas shifrave të publikuara nga Basha, nga 6140 biznese të mbyllura në periudhën janar-gusht 2017, kjo shifër ka shkuar në 9260 në të njëjtën periudhë të vitit aktual, një rritje me rreth 30%.

fshatrave do të mund t'i përgjigjemi thirrjes për një aksion radikal politik, që të ketë synim largimin e këtij kryeministri dhe të kësaj qeverie. Që nga ky moment, që kur të ndahemi prej këtij takimi, puna duhet të nisë derë më derë me njerëzit. Sot rrugë tjetër përveç përballjes nuk ka.



PS, Felaj: Opozita nuk do hetim, por justifikim

Kryetarja e Komisionit parlamentar të Sigurisë, Ermonela Felaj reagoi dje pas kërkesës së opozitës për shkarkimin dhe ndjekjen penale të ministrit Fatmir Xhafaj dhe drejtorit të policisë, Ardi Veliu. "Opozita i paska kërkuar Kuvendit zgjatje të afatit të komisionit hetimor për trafikun e drogës edhe me 3 muaj të tjerë! Po 6 muajt që Kuvendi i dha afat këtij komisioni, ku i shkuan opozitës? 3 a 4 herë e mbledhi gjithsej komisionin z.Paloka, edhe pse disa herë publikisht i kërkuam z.Paloka ta thërriste komisionin, dhe sot u kujtua se i skadoi afati! E vërteta është e thjeshtë: nuk donin, nuk duan hetim, bllokuan me dashje çdo kërkesë të mazhorancës për të hetuar nëpërmjet këtij komisioni. Kishin dhe kanë frikë për atë që mund nxirrej në dritë nga ky komision hetimor dhe tani duan vetëm justifikimin. Ata nuk duan hetim!", shkruan ajo. Sipas Felajt, opozita do thjesht një tribunë nga ku të ripërsërisë akuzat bajate dhe të stërdëgjuar! "Edhe njëherë, origjina e trafikut të drogës në Shqipëri nis bashkë me qeverisjen e PD, që fatqësisht asnjëherë nuk luftoi seriozisht ndaj fenomenit, përkundrazi e ngriti në sistem atë, e favorizoi me ligji dhe lidhjet e tyre me trafikë të filluara që atëherë, vijojnë edhe sot!", u shpreh deputetja e PS-së.

Paloka, Ramës: I shkrive të varfrit për luksin tënd

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka e quan blasfemi shprehjen e kryeministrit Edi Rama se udhëhiqet nga fjalët e mençura të Nënë Terezës. Ai thekson se askush nuk mund të bëjë një anatemi të tillë ndaj shenjtoreve shqiptare dhe e akuzon kryeministrin se fle me krimin. Deputeti demokrat i kujton më tej Ramës çarтерin dhe foton me Ronaldon dhe thotë se i shkriu të varfrit për luksin e tij. "Bestemnia, Rama deklaroi se udhëhiqet në rrugën e tij nga fjalët e Shën Terezës! Asnjë politikan, më i miri qoftë, nuk mund të bëjë anatemi të tillë ndaj shenjtoreve shqiptare. Imaginoni që këtë guxim e merr Rama, ai që fle me krimin në krevatin e pushtetit. Shën Tereza shkriu gjithçka për të varfrit dhe të pamundurit, ky shkriu të varfrit dhe të pamundurit për luksin e tij dhe guxon të thotë se drejtohet në rrugën e tij nga fjalët e shenjtoreve. Ky që u mburr se mori çarтерin për të bërë foto me Ronaldon, si të ishte biri adolehent i ndonjë sheiku dhe jo kryeministri i vendit më të varfër në Evropë...", shprehet z.Paloka.



Valentina Madani

Opozita intensifikon përpjekjet e saj për shkëputjen e lidhjeve të pushtetarëve me krimin. Në funksion të kësaj nisme, Partia Demokratike i dërgoi dje një letër kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, ku akuzoi ministrin e Brendshëm se ka penguar qëllimisht komisionin që do të hetonte përfshirjen e qeverisë në kultivimin dhe trafikimin e drogës, duke fshehur informacionin dhe dokumentet. Në letërën që PD i drejton kryeparlamentarit Ruçi thuhet se, "Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit nuk i kanë vënë në dispozicion për 5 muaj asnjë dokument komisioni hetimor". "Edhe pse komisioni hetimor që prej muajit prill 2018 ka kërkuar informacione nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, deri më sot në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin, komisionit nuk i është vënë në dispozicion asnjë e dhënë apo dokumentacion i kërkuar, duke pamundësuar punën e tij", - thuhet në letërën e Palokës. Gjithashtu, PD akuzon ministrin Xhafaj për asgjësim provash në mbrojtje të të vëllait trafikant siç thotë ajo, si dhe Tahirit, Ballës, Çyrbjes etj. Në letërën drejtuar Ruçit, Paloka shpreh se, "pengimi i komisionit hetimor është bërë me qëllim për të fshehur gjurmët e lidhjes së qeverisë me krimin e organizuar dhe për asgjësimin e informacioneve dhe provave që përfshijnë në veprimtari kriminale vëllain e dënuar për trafik droge të ministrit aktual të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, si dhe vetë ekspozentët e lartë të Partisë Socialiste si Saimir Tahiri, Fatmir Xhafaj, Taulant Balla, Jyrgys Çyrbja etj.". Edi Paloka thekson se heqja e së drejtës kushtetuese të opozitës për të kontrolluar qeverinë shënon fundin e parlamentarizmit dhe është dhunim flagrant i demokracisë funksionale në vend. Partia Demokratike i kërkon kryetarit të Kuvendit të marrë masa për përgjegjësit e pengimit të qëllimshëm të komisionit që do të hetonte përfshirjen e qeverisë në kultivimin dhe trafikimin e drogës. "Kërkojmë nga Kuvendi i Shqipërisë qëndrim të prerë ndaj aktit të veprimitarisë së komisionit hetimor, duke marrë masat e duhura për të vënë përpara përgjegjësisë politike dhe ligjore ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pengimi i qëllimshëm i komisionit hetimor përbën shpërdorim detyre, që sjell sh-

LETRA

"Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit nuk i kanë vënë në dispozicion për 5 muaj asnjë dokument komisionit hetimor. Ministri i Brendshëm dhe kreu i policisë akuzohen nga PD për pengim të qëllimshëm të komisionit hetimor 'Tahiri'. Pengimi i komisionit ka qëllim fshehjen e gjurmëve të lidhjeve të qeverisë me krimin e organizuar", lexohet në letër.



HETIMI

PD akuzon z.Xhafaj për asgjësim provash në mbrojtje të të vëllait trafikant si dhe Tahirit, Ballës, Çyrbjes etj. "Mandati i komisionit hetimor përfundoi dje pa asnjë rezultat për shkak të pengimit të qëllimshëm të punës nga qeveria. Pengimi i komisionit hetimor nga qeveria është dhunim i Kushtetutës dhe asgjësim i parlamentit".



Beteja kundër kriminit, demokratët kërkesë kreut të Kuvendit: Të largohet edhe Veliu

PD, letër Ruçit: Të shkarkohet dhe të ndiqet penalisht Xhafaj

"Penguan komisionin hetimor 'Tahiri'"



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardian Veliaj

KERKESA
"Kërkojmë nga Kuvendi i Shqipërisë qëndrim të prerë ndaj aktit të pengimit të veprimitarisë së komisionit hetimor, duke marrë masat e duhura për të vënë përpara përgjegjësisë politike dhe ligjore ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

karkim nga detyra dhe përgjegjësi penale", - thuhet në letërën e Palokës. Duke vënë në dukje përfundimin e afatit të komisionit hetimor më 5 shtator, kryetari i komisionit hetimor, Edi Paloka kërkoj në emër të Partisë Demokratike shtyrjen me 3 muaj të tjerë të veprim-

tarisë së komisionit. Komisionit hetimor që u ngrit këtë vit për të kontrolluar përfshirjen e qeverisë nëpërmjet ish-ministrit të

Brendshëm, Saimir Tahiri dhe Policisë së Shtetit në lëndëve narkotike nuk ka dhënë asnjë rezultat.

"KED ka kuorum dhe mundësitë që të funksionojë"

Ngërçi i Gjykatës Kushtetuese, Meta dhe Ruçi përplasen me interpretime



VETINGU

Mësohet se mazhoranca do të presë të shikojë nëse pesëshja aktuale do t'i mbijetojë vetingut, gjë që do të thotë se edhe ngërçi me Gjykatën Kushtetuese do të vijojë të qëndrojë.

ANËTARËT FUNKSIONALË TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI:

- Anëtarët e KED funksionale sipas Presidencës:
1. Vitore Tusha - zëvendësuese nga GJK (kaluar vetingun).
 2. Anton Dhimitri - gjyqtar nga gjykatat e Apelit (në proces rivlerësimi).
 3. Fatos Qato - gjyqtar nga gjykatat e Apelit (në proces rivlerësimi).
 4. Fatjona Memçaj - prokurore pranë gjykatave të Apelit (kaluar vetingun).
 5. Ahmet Jangulli, gjyqtar nga gjykatat administrative (në proces rivlerësimi).
- Anëtarët zëvendësues funksionalë:
Sotirraq Lubonja nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në proces rivlerësimi).

anëtares së Gjykatës Kushtetuese, Vitore Tusha, që të drejtojë mbledhjen e KED-së me cilësinë e zv.kryetares. Sipas kreut të shtetit, këta pesë anëtarë e bëjnë legjitime KED-në. Në letërën drejtuar

Kuvendit, presidenti thekson se KED mund të mblidhet e të vendosë sipas tagrit të saj mbi kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, që gjithashtu është jashtë funksioni për shkak

të mungesës së kuorumit. "Çdo vonesë dhe mosmbledhje është e pajustifikueshme", shpreh Presidenti Meta, ku thekson gjithashtu se ai e ka të pamundur të hedhë një tjetër short për anëtarët të KED-së jashtë hapësirës kohore 1-5 dhjetor, që i nje ligji për këtë. Në këto interpretime, presidenti ndahet edhe me socialistët. Juristët e PS-së, anëtarë të Komisionit të Ligjeve, i thanë "Top Channel" se Meta ka të drejtë kur mendon se KED ka ende kuorum, por sipas partisë në pushtet pa kaluar vetingun anëtarët e këtij organizmi nuk mund të vendosin për fatin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kryeministri sqaron vendimin e qeverisë, vizitë në familjen me ndihmë ekonomike

Rama: Libra falas edhe për fëmijët e familjeve në nevojë

Ndihma për jetimët, Xhaçka: Ushtrarakët me kuletë të vogël, por me zemër të madhe

Librat falas këtë vit janë për të gjithë nxënësit e klasave nga I në IV, po edhe për nxënësit e familjeve në nevojë, deri në klasën IX. Me urimin për një vit të ri shkollor të mbarë, kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga zëvendësministrja e Arsimit, Besa Shahini, ishin në familjen Musi, në Allias, e cila përfiton ndihmën ekonomike dhe si e tillë gëzon të drejtën e marrjes së librave falas për dy djemtë, Agimin dhe Manuelin, që këtë vit nisin klasën e 5-të dhe të 6-të. Këtë vit, falë nismës së re të qeverisë, librat po shpërndahen falas në të gjithë territorin e Republikës për fëmijët nga klasa e parë në të katërtën, por ndërkohë jepen falas edhe për fëmijët e familjeve me ndihmë ekonomike që ndjekin klasën e 5-të e lart. "Ne i kemi bërë librat falas nga klasa e parë në të katërtën, por ndërkohë për të gjithë ata që janë nga familje që kanë disa nevoja më shumë se të tjerët, librat janë falas dhe kështu balancohen të dyja. Nga e para në të katërtën është për të gjithë, nga e pesta e më lartë është vetëm për ata që janë familje në nevojë, fëmijët e tretë", tha kryeministri Rama. E pranishme në dhënien e librave për Agimin dhe Manuelin, ishte edhe mesuesja kujdestare, e cila i vlerësoi të dy fëmijët për interesin dhe vëmendjen që tregojnë për mësimin. Manuelli ka pasionin futbollin dhe këtë vit një risi është hapja e klasave sportive ku ai mund të tregojë pasionin e talentin e tij, risi të cilën mesuesja e vlerësoi si një mundësi për të gjithë fëmijët që e kanë pasionin sportin. Zëvendësministrja e Arsimit, Besa Shahini tha se projekti i pilotuar vjet në disa shkollat, "Bëjmë detyrat e shtëpisë" do të shtrihet edhe në shkollat të tjera, ndër të cilat edhe në shkollën ku dy djemtë mësojnë. Në prag të fillimit të vitit të ri shkollor punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Armatosur iu bashkuan nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve. Çanta dhe mjetet shkollore iu dhuruan vogëlshëve në prag të vitit të ri shkollor.



Kryeministri Edi Rama duke shpërndarë libra falas

Gjatë vizitës në muzeun ushtarak, fëmijët dhe të afërmit e tyre janë përshëndetur nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e cila u uroi një vit të ri shkollor sa më të mbarë e të suksesshëm. "Ushtrarakët tanë kuletën nuk e kanë të madhe, por e kanë zemrën e madhe. Siç punojnë e sakrifikojnë me dashuri për atdheun, ashtu jam e bindur do të

gjejnë edhe mundësitë për të bërë maksimumin për t'u ardhur në ndihmë vazhdimisht të dashurve tanë që janë sot të pranishëm këtu me ne. Jam shumë e kënaqur që mbështetjen tonë përmes kontributit të punonjësve të MM e FA, Kryqi i kuq e ka përkthyer në duratën më domethënëse, e më të mirë të mundshme këtë prag viti sh-

ALBANA VOKSHI
Deputetja e PD, Albana Vokshi tha se braktisja e shkollave nga 133 mijë nxënës dhe mbyllja e dhjetëra shkollave, është rezultati shkatërrimtar i qeverisë "Ram'a për arsimin. "Lindita Nikolla duhet t'u thotë shqiptarëve sa shkolla po mbyllen në të gjithë Shqipërinë për shkak të braktisjes së tyre nga 133 mijë nxënës gjatë qeverisjes së Edi Ramës. Mbyllja e dhjetëra shkollave në çdo bashki të Shqipërisë tregon agoninë në të cilën arsimi shqiptar ka rënë",-tha ajo.

kollor. Kjo çantë shkollë përmban të gjithë pajisjet mësimore që do t'ju duhen për vitin shkollor e është një mundësi më shumë për të dalë mirë në shkollë e për t'u bërë në të ardhmen të zotët e vetes. Jam bindur se një ditë ju do të jeni krenaria jonë, në të gjitha fushat e jetës",-tha ministrja Xhaçka gjatë takimit me fëmijët.



"Ecuria e punëve andej e këtej bëshkëve", Rama takon Shpend Ahmetin dhe Visar Ymerin

Në kulmin e debatit për kufijtë mes Kosovës dhe Shqipërisë, kryeministri Edi Rama ka pritur kryetarin e Komunës së Prishtinës Shpend Ahmeti, por edhe deputetët e tjerë të Partisë Social Demokratike Visar Ymeri dhe Aida Dërgutin. Lajmin për takimin e tyre e kanë dhënë vetëm Rama dhe Ahmeti, të cilët kanë shpërndarë nga një foto në rrjetet sociale. "Me Shpendin, Aidën, Visarin dhe Elisën, duke këmbyer sot opinionet për ecurinë e punëve andej e këtej bëshkëve",- shkruan Rama në Instagram. Ndërsa në "Facebook", Shpend Ahmeti shkruan: "Bashkë me nënkryetarin Visar Ymeri, dhe Sekretaren Aida Dërguti në takim me Kryeministrin Rama për të diskutuar bashkëpunimin ndërpartiak, si dhe zhvillimet aktuale politike."

DEPUTETJA E PD-së

Dhurata Çupi: Po diskutohet edhe djegia e mandateve

Në tryezën e diskutimeve për aksionin e opozitës po diskutohet edhe djegia e mandateve. Këtë e bëri të ditur deputetja e PD, Dhurata Çupi në studion e lajmeve të Ora Neës. Çupi tha se po diskutohet të gjitha opsionet, përfshi edhe djegjen e mandateve. Ai deklaroi se është ngritur një grup i përbërë edhe nga teknikienë, që do të vendosi një plan të punës të gjitha grupeve parlamentare të opozitës. "Të gjitha opsionet janë të mundshme. Ajo që sot ne duhet të diskutojmë është çfarë i sjell mirë qytetarit. I sjell mirë qytetarit një grup parlamentar opozitar që do të qëndrojë pranë qytetarëve, denoncon çdo aferë të kësaj mazhorance, apo një grup parlamentar që mos të jetë dhe të jetë inekzistent. Pra djegia e mandateve mbetet opsion. Po diskutohet të gjitha opsionet, ka një grup pune me kryetarët e partive opozitare dhe më gjerë, me teknikienë dhe politikanë me eksperiencë. Ky grup do të vendosi një plan të punës të gjitha grupeve parlamentare të opozitës. Do të jetë i detajuar, do bëhet publike dhe do diskutohet në detaje me çdo qytetar si do të dilet nga kjo gjendje kritike",-tha Çupi. Ajo paralajmëroi, gjithashtu, se do të ketë protesta. "Do kemi aksion politik, do ketë protesta, do ketë denoncime, do ketë lëvizje politike. Ne i kemi premtuar qytetarëve dhe do jemi pranë qytetarëve",-u shpreh Çupi.

Kryeministri i Maqedonisë: Do të ngremë flamurin në Durrës

Zaev: Rama na premtoi se do na japë një port për shkëmbime tregtare

Shqipëria do t'i japë Maqedonisë mundësinë për një port në Durrës, të cilin do ta shfrytëzojnë kompanitë maqedonase për shkëmbim tregtar, ndërsa në të do të valëvitet edhe flamuri i Maqedonisë", ky është premtimi që kryeministri shqiptar i ka bërë homologut të tij maqedonas, sipas mediave në këtë vend. Lajmi konfirmohet nga kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev, i cili citohet nga mediat maqedonase, këtë ia ka premtuar homologu, Edi Rama. Deklarata e Zaev është bërë gjatë një aktiviteti të organizuar dje, në Odën Ekonomike të Maqedonisë. Para sipërmarrësve



maqedonas Zaev foli edhe për përfitimet e Maqedonisë nga marrëveshja me Greqinë dhe integrimin euro-atlantik. Kryeministri i Maqedonisë tha se pas atij në Durrës, ata synojnë që të hapin edhe një port në Bullgari. "Ja për shembull, me kryeministrin e Sh-

qipërisë kemi të garantuar se do të na japin një port në Durrës ku do të valëvitet flamuri maqedonas. Kjo do të ndikojë në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve që portet ofrojnë për kompanitë e Maqedonisë. Një tjetër çështje është që të lidhemi me Bullgarinë, përmes Detit të Zi dhe besoj se kjo do të ndikojë shumë në konkurrencën çmimeve, ofrimin e kushteve më të mira për shfrytëzimin e porteve", deklaroi Zaev. Në aktivitetin e djeshëm, Zaev tha se përfuttes më të mëdhenj nga marrëveshja me Greqinë dhe ajo me Bullgarinë do të jenë sipërmarrësit dhe qytetarët.

Audio-përgjimi/ nënkryetari i KQZ-së: Shumë zhurmë për asgjë

Biba: Basha të kujtojë orët e gjata të 17-18 majit vetëm për vetëm me Ramën

Nënkryetari i KQZ-së Denar Biba i përfshirë në një audio-përgjim megjyqtarin e Strasburgut Ledi Bianku, në një analizë të tij i ka thënë kreut të PD-së, Lulzim Basha se përpara se të shprehej për takimin e tij me z.Bianku, do të bënte mirë të kishte sjellë ndër mend orët e gjata të kaluara vetëm për vetëm me z.Rama në mesnatën e 17-18 majit 2017, si edhe etiketimet e gjithfarëlojshme që i mvëshën kësaj bisede keqdashësit e tij politikë". Në një postim në rrjetin social, "Facebook", nënkryetari i KQZ-së, i akuzuar për shantazh ndaj Biankut për çështjen e pronave shprehet: "Shumë herë më e parëndësishme ishte biseda ime me z.Bianku, nëse merr parasysh faktin se, si unë dhe ai, nuk kishim asnjë kapacitet vendimmarrës në lidhje me shtrjten e kërkuar". Ai thotë se biseda të tilla ka pasur e



Nënkryetari i KQZ-së
Denar Biba

do të ketë, gjithmonë dhe se duke i "babalizuuar" ato, opozita nuk bën gjë tjetër veçse, me naivitet, i jep një dimension negativ, krejtësisht të panevojshëm, një instrumenti që më së shumti është në favor të saj. "Qas-

jet" mes shtetarëve dhe diletantizmi i politikës", e titullon nënkryetari i KQZ-së komentimin e tij. Ndërsa ka treguar se nuk i ka bërë ndonjë përshtypje të madhe audio-përgjimi i publikuar në media, Biba shprehet:

"Jam i vetëdijshëm për etjen që ka opozita për skandale qeveritare, por sërish, nga pozita e atij që dinte të vërtetën, nuk arrija dot ta vendosja tekstin e publikuar në kornizën e një skandali". "Së pari, por jo nga rëndësia, dua të vërej për lexuesin "babalizimin që iu bë një bisede mes dy miqsh, ndonëse në një pjesë të saj u fol edhe për interesa shtetërore",-u shpreh Biba. "Mirë për mua nuk mendoi, por z.Basha kishte detyrim të mendonte për imazhin e gjyqtarit shqiptar në Strasburg dhe të parashikonte sesi do dilte ky imazh pas publikimit të një bisede krejt të parëndësishme për politikën",-tha ai më tej. "Shumë zhurmë për asgjë, vërtet, por që ekspozoi një diletantizëm të frikshëm nga një pjesë e politikës shqiptare",-i cilësoi Biba, audio-përgjimin dhe akuzat e opozitës.

Vasili: PS, grup kuislingësh që kanë tradhtuar njerëzit

Kreu i Grupit Parlamentar i LSI-së, Petrit Vasili tha dje, se opozita nuk do të marrë pjesë në seancën e sotme të Kuvendit. Vasili tha se opozita e bashkuar do të mbledhet nesër në qytetin e Elbasanit, ndërsa mazhoranca do të miratojë në Tiranë një akt normativ për të vjedhur sërish paratë e qytetarëve. "Është zyrtare mbledhja e grupeve parlamentare të opozitës do të zhvillohet në qytetin e Elbasanit, ndërkohë që në Tiranë do të mbledhet një grup deputetësh që e quajmë veten mazhorancë, që do të rivënë nesër (sot) në Kuvend një projektligj për të vjedhur sërish, ku kjo pjesë e parlamentit janë një grup kuislingësh që kanë tradhtuar njerëzit dhe do të votojnë një akt normativ për të vjedhur paratë",-tha Vasili në syri.net. Kreu i Grupit Parlamentar i LSI-së tha se kryeministri Edi Rama ka mashtruar shqiptarët me audio-përgjimin ku është i përfshirë vëllai i ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj. Ai tha se edhe pse kanë kaluar muaj që këtë çështje e ka marrë në dorë prokuroria, nuk kemi një përgjigje, pasi Rama nuk e lejon të thotë të vërtetën.



Kryeministri Edi
Rama dhe ministrja
Lindita Nikolla



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

TRANSFEROHU NË UET
MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Shoqata e pronarëve kundërshtoi ligjin e pronave në Kushtetuese: U dëmtuam me 4.4 mld euro

Vorpsi: Fatura reale për pronarët, 4.9 miliardë euro

Gjykata e Strasburgut jep sinjal për rrëzimin e ligjit të pronave

Ornela Manjani

Ish-pronarët marrin sinjale pozitive nga Gjykata e Strasburgut për rrëzimin e ligjit 133/15 për pronat. Fatura e pronave arrin në rreth 4.9 miliardë euro, sipas çmimeve të vitit 2016, ndërkohë me ligjin në fuqi janë vlerësuar 9 herë më pak. Myrshit Vorpsi, kryetar i Shoqatës Kombëtare 'Pronësi me Drejtësi' bën të ditur se Ligji 133 i qeverisë "Rama" për vlerësimin dhe kompensimin e pronave jo vetëm që nuk e zgjidhni çështjen e pronave, por duket se e ka thelluar më tej. Shoqata 'Pronësi me Drejtësi' ka depozituar 5 çështje të cilat presin të shqyrtohen. "Sipas skemës së përlogaritur në bazë të ligjit të qeverisë, Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka konkluduar se shteti shqiptar u detyrohet pronarëve një vlerë kompensimi prej 629 milionë euro. Ndërkohë që sipas çmimeve të vitit 2016, kjo vlerë është 9 herë më e vogël, pasi vlera reale përlogaritët në 4.9 miliardë euro", shprehet Myrshit Vorpsi. Ndërkohë që pronarët shqiptarë presin plotësimin e kuorumit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Strasburgut e ka dhënë sinjalin e parë që skema e qeverisë për kompensimin e pronarëve nuk është e drejtë. "Në çështjen 'Sharra' kundër shtetit shqiptar, gjykata e Strasburgut ka vendosur të mos pranojë mënyrën e kompensimit të vendosur nga qeveria shqiptare. Strasburgu i thotë qeverisë që pronarët duhet të kompensohen me vlerën reale që ka toka dhe jo me vlerën që ka pasur në kohën kur është shpronësuar", thotë Myrshit Vorpsi. Por, sipas Vorpsit kjo përpjekje e shtetit shqiptar për të ulur në maksimum vlerën e kompensimit për pronarët i ka dhënë disa efekte. "Ata që nuk e kanë ankimuar vendimin e agjencisë brenda 30 ditëve e humbin të drejtën e ankimit dhe të përfitimit edhe nëse nesër qoftë Gjykata Kushtetuese apo edhe ajo Strasburgut shfuqizojnë ligjin në fjalë", tha Vorpsi.

VENDIMET 2015
Që nga viti 2015 janë 89



Myrshit Vorpsi, kryetar i Shoqatës Kombëtare 'Pronësi me Drejtësi'

Kufiri, 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur

Llogaritja sipas ligjit në fuqi

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Këtë pikë e kundërshtojnë fort pronarët, pasi sipas tyre zhvlerëson pronën. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit deri në masën 50 sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015 dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht nga fondit i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për tra-



jitimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Agjencia e Trajtitimit të Pronave vijon procedurat duke administruar aplikimet e pronave, të cilët duket të cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet: kërkesa për kompensim fi-

Vlerësimi që ka publikuar Agjencia e Trajtitimit të Pronës është 10 herë më i ulët se sa detyrimi që shteti shqiptar, me çmimin e 2016 duhet të kishte ndaj pronarëve shqiptarë. Myrshit Vorpsi nga Shoqata Kombëtare

për Pronësi thotë se Strasburgu i ka lënë qeverisë shqiptare afat deri në 17 shtator të këtij viti ta njohë me mekanizmin që do të përdorë për kompensimin e pronarëve në kuptimin e ligjit të ri të pronave miratuar në

46

MJE
Në ATP, e cila po operon me ligjin që kundërshtojnë pronarët janë rreth 46 mijë vendime, prej të cilave 11 mijë vendime presin të marrin një vendim kompensimi me ligjin e ri. Lista me pronarët që presin kompensim është nga i gjithë vendi, por peshën më të madhe e ka kryeqyteti.

3-5

MILIARDE
3-5 miliardë lekë në vit do të jetë fondi për kompensimin e pronarëve sipas ligjit që pritet të miratohet, për të cilin pronarët kanë kontestime. Në draft thuhet se fondi vjetor buxhetor me rritje progresive të detyrueshme mesatarisht 5 mld lekë.

PRONA E NJOHUR PËR KOMPENSIM

Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet si më poshtë vijon:
a) Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit.
b) Prona e kthyer vlerësohet sipas zërit kadastral aktual të saj dhe sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, duke logarituar diferencën e vlerës, që do të rezultojë nga ndryshimi i zërit kadastral.
c) Kur nga ky vlerësim rezultojnë se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së.

nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

nanciar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i apo vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar

Permbuesi Gjyqësor Privat Çezar Beja
Administrative Manez, Bashkia Durrës
Çmimi në ankandin e dytë është 2.534.400 lekë
2.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 39/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 62, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njesia Administrative Manez, Bashkia Durrës
Çmimi në ankandin e dytë është 4.316.400 lekë
Ankandi do të zhvillohet në zyrën e permbuesit gjyqësor privat Çezar Beja në datën 20.09.2018 duke u mbyllur në orën 16:00

Shtitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C
"Apartamenti", me sip. 69.2 m2, Nr pasurie 10/158+2-1, Z K8631, vol. 9, fq 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1 Lezhe, Prona eshte e regjistruar pranë Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Lutizim Kros Beqiri. Çmimi i ri per shtitje eshte 2.170.000 Lekë.
Data e shpalljes 06.08.2018
Data e zhvillimit 11.09.2018 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
PASURIA E LLOJIT 'PYLL+KULLOTË', ME SIPERFAQE 190.000 M2, ZONAKADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NË PRONËSI TË Z. FATIUN UKA.
ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.09.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Qeveria shqiptare nëpërmjet Komitetit të Planifikimit Strategjik ka përzgjedhur 143 projekte prioritare publike, të cilat kushtojnë 13.7 miliardë euro, sipas burimeve zyrtare nga Ministria e Financave. Kjo paketë e miratuar tashmë nga Komiteti i Planifikimit Strategjik përbëhet nga projekte dhe përfshin sektorët: transporti (rrugor, hekurudhor, detar, ajror); energjia (Transmetim, efikasiteti i energjisë); mjedisi (uji dhe kanalizimet, mbrojtja nga përmbytjet, ndotja e ajrit); infrastruktura sociale (arsimi & sportet, shëndeti,

Qeveria identifikon 143 projekte prioritare Ja ku do të shkojnë 13.7 miliardë euro

arti-kultura, mbështetje për burgjet, banesat sociale, arsimi profesional); infrastruktura e biznesit (marina, turizëm dhe infrastruktura broadband). Ministria e Financave shprehet se grupi i menaxhimit të buxhetit ka organizuar tri mbledhje për të koordinuar dhe për të kryer një analizë teknike të shëndoshë të projekteve pjesë e paketës. Paketa përbëhet nga 2 kategori kryesore: Kategoria I, projektet rajonale me kosto 2,2 miliar-

dë euro. Në kategorinë e parë përfshihen projektet e rrejtë kryesor dhe projektet e zhvillimit ndërkufitar të Ballkanit. Në të përfshihen 21 projekte me një kosto totale investimi prej 2,2 miliardë euro. Ministria e Financave pohon se boshllëku financiar për këtë kategori është 79%. Pjesa tjetër e investimeve përbëhet nga 3% grante, 6% hua dhe 2% nga buxheti kombëtar nëpërmjet PBA-së. Në këtë kategori është parashikuar që 10% e

shumës totale të mund të zbatohet nëpërmjet financimit të PPP-ve si një burim potencial. Kategoria II, projektet me rëndësi kombëtare kushtojnë 11.5 mld euro. Në kategorinë e dytë të paketës së projekteve strategjike janë ato me karakter kombëtar dhe rajonal, që përfshijnë tri nënkategori projektësh: kombëtare, zhvillim rajonal dhe zhvillim lokal. Kostoja e investimeve totale për këtë kategori është 11.5 miliardë euro, nga e cila rezultojnë një boshllëk fi-



nciar prej 28%. Shuma e granteve për këto kategori është 3%, 13% për hua dhe 3% nga buxheti i shtetit nëpërmjet PBA-së. Në këtë kategori, 11% e shumës totale është parashikuar si një potencial për financimin nga PPP-të dhe 42% si potencial nga investimet private.

Rregullat e reja për dosjet për regjistrimin e pasurive të paluajtshme

Kreu i Hipotekës: Trajtimi i praktikave të prapambetura, brenda shtatorit

Regjistrimet, Pjetri: Duhet të plotësohen vetëm me një akt verifikimi

Të gjitha praktikave të prapambetura për regjistrimin e pronave do të mbyllën brenda muajit shtator. Ndërsa regjistrimi i pasurive të paluajtshme do të kryhet pasi të plotësohet vetëm një akt verifikimi të dosjes. Këto janë dy porositë që kreu i Hipotekave, Valdrin Pjetri u ka dhënë vartësve të tij në një mbledhjen e fundit.

REGJISTRIMI

Qytetarët duhet të plotësojnë dosjet për regjistrimin e pasurive të paluajtshme vetëm me një akt verifikimi. Deklarata vjen nga kryeregjistruesi Valdrin Pjetri, në mbledhjen me drejtuesin e ZVRPP-ve, ku kërkoi zbatimin rigoroz të urdhrit të lëshuar prej tij, që përcaktonte nxjerrjen e një akti verifikimi për një dosje. "Akt verifikimi për një dosje të ketë vetëm një. Ka raste kur punonjësit bëjnë pingpong me qytetarët duke u kërkuar plotësimin e dosjes me disa akt verifikime. Të studiohet mirë dosja dhe të dalë vetëm një akt verifikimi. Ju kërkohet zbatimin e urdhrit të nxjerrë nga kryeregjistruesi me nr. 937, datë 12.06.2018 për këtë çështje", tha Pjetri. Duke vënë në qendër të vëmendjes së Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme shërbimin ndaj qytetarëve, Pjetri u ka kërkuar drejtuesve vendorë që të verifikojnë çdo ankesë të platformës së bashkëqeverisjes, si dhe ka paralajmëruar largimin e punonjësve që kanë abuzuar me afatet e dhënies së këtij shërbimi. Po ashtu, një tjetër kërkesë e tij në drejtim të regjistruesve ka qenë edhe ajo për trajtimin e praktikave të prapambetura brenda datës 31 shtator 2018.

REGJISTRIMET

Regjistrimi i kontratave të shitjes, të dhurimit të heqjes dorë nga prona, regjistrimi i kontratës së shkëmbimit apo akti i trashëgimisë shoqërohen



Kreu i Hipotekave, Valdrin Pjetri gjatë një mbledhjeje

RREGULLAT

Akt verifikimi për një dosje të ketë vetëm një. Ka raste kur punonjësit bëjnë pingpong me qytetarët duke u kërkuar plotësimin e dosjes me disa akt verifikime. Të studiohet mirë dosja dhe të dalë vetëm një akt verifikimi.

me një sërë dokumentacioni, i cili duhet të jetë i plotësuar në momentin që pronari i një pasurie do të kryejë një veprim me të tek noteri. Janë 51 veprime që kryhen me pronësi nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Regjistrimi i akteve materiale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të pa-

surisë apo me subjektet e treta kushtojnë 3500 lekë. Ndërsa regjistrimi i të gjitha kontratave për shitje, dhurim, heqje dorë nga pronësia, shkëmbim, dhënie me qira apo akt trashëgimie do të kushtojnë nga 700 lekë deri në 3500 lekë. Konsultimi i kartelës së pasurisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme do të ketë një

tarifë prej 700 lekësh. Ndërsa verifikimi 'online' i gjendjes juridike të pronësive në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme do të ketë tarifën 600 lekë. Sipas kryetares së Dhomës së Noterisë, regjistrim i kontratës së shitjes, kontratës shkëmbimit dhe kontratës së dhurimit me rezervë/kusht të pasurisë së paluajtshme do të kushtojë 900 lekë. Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kreditues për kredi me vlerë deri në 1.000.000 lekë do të ketë një tarifë prej 7500 lekë.

DOCUMENTET

Sipas listës së Hipotekës, për regjistrimin e kontratave të shitjes së pronës duhet: dokument identifikimi, kontrate shitjeje, deklaratë noteriale, vërtetim nga organi i njësive vendore mbi përbërjen e familjes, certifikatë e gjendjes familjare dhe deklaratë e anëtarëve të familjes bujqësore për zgjedhjen e një përfaqësuesi të ri të familjes bujqësore. Ndërsa për lëshim kopjeje të fragmentit të hartës kadastrale duhet: harta treguese e pasurisë, planrilevimi, kartela e pasurisë dhe dokument identifikimi. Ndërkohë që për regjistrimin apo fshirje e hipotekës ligjore duhet që personi i interesuar të ketë: vendim gjykatë për fshirje, deklaratë noteriale, dokument identifikimi, vendim gjyqësor ose akt noterial për vendosjen e hipotekimit, kartela e pasurisë (kopje) dhe harta treguese e pasurisë.

SHKURT

AKU bllokoi 51 tonë miell misri për kafshë nga Serbia

Në kuadër të masave të përforuara për sigurinë e cilësinë ushqimore të produkteve që importohen, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka konstatuar dhe bllokuar një ngarkesë prej 51 tonë miell misri për kafshë. Trupa inspektuese e DRAKU, Kukës gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën Doganore Morinë evidentoj dy subjekte, të cilat do të fusnin në Republikën e Shqipërisë produktin "miell misri për kafshë" me origjinë nga Serbia. Konkretisht, mielli i misri për kafshë, me sasi 25 tonë dhe 26 tonë u konstatua se në dokumentacionin që shoqëronte ngarkesën, gjithsej 51 tonë, kishte nivelin (8.6) më të lartë se norma e lejuar (5). Gjithashtu, kjo ngarkesë nuk kishte raportshmëri me dokumentacionin shoqëruar. Pra, raport-analiza nuk ka nr. lotti, datë prodhimi/skadimi që ta lidhë me produktin 51 tonë miell misri për kafshë. Menjëherë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit bëri bllokimin e ngarkesës bazuar në legjislacionin në fuqi dhe do të ndjekë procedurat doganore për kthimin në origjinë. AKU thekson se do të jetë gjithmonë në mbështetje të konsumatorit, me qëllim garantimin e Sigurisë Ushqimore. Gjithashtu, inkurajon të gjithë qytetarët të denoncojnë çdo rast shkeljeje apo tregim jashtë standardëve, për të parandaluar çdo tentativë abuzimi pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në info@aku.gov.al si dhe pranë portarit të bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam". Siguria Ushqimore është një sfidë e përbashkët.

Tatimet fillojnë fushatë informimi për bizneset

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve njofton se me mbështetjen e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po ndërmerren një fushatë të gjerë informimi për tatimpaguesit. Për 11 kategori të ndryshme tatimpaguesish (persona juridikë, persona fizikë, ambulante, individë dhe fermerë) janë hartuar broshura dhe video informuese, me të cilat DPT do t'ju njohë në vazhdimësi. Ato përmbajnë informacion të detajuar për të gjitha hapat e ciklit të jetës së një biznesi nga regjistrimi, deklarimi, pagesat e detyrimeve, si dhe të drejtat e detyrimit e tjera lidhur me administratën tatimore. Informacioni është përshtatur për secilën prej kategorive të identifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe ofrohet në formate që mund të përdoren dhe kuptohen lehtësisht nga të gjithë. Qëllimi i kësaj nisme është krijimi i një platforme të gjerë informimi, si për bizneset ekzistuese, ashtu edhe për ato që regjistrohen rishtas, mbi hapat që duhet të ndjekin për të plotësuar kërkesat tatimore. Gjithashtu, synohet edhe përmirësimi i mbledhjes së detyrimeve tatimore, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

"Ky është kërcënimi i dytë. Liria e medias është thelbësore për një vend demokratik"

Sulmi në banesën e prindërve, Klodiana Lala: Të qëllosh drejt femijëve, monstrooze

Gazetarja: Akt barbar prej burracakësh

TIRANE

Banesa e prindërve të gazetares së "News 24", Klodiana Lala u sulmua me armë gjatë orëve të para të mëngjesit të 30 gushtit, në rrugën "Shkëndija" në fshatin Bruk në Tiranë. Kur kanë kaluar gjashtë ditë nga sulmi në banesën ku në momentin e ngjarjes ndodheshin edhe dy vajzat e saj të mitura, gazetarja Klodiana Lala ka vendosur të thyejë heshtjen. Në studion e "News 24", gazetarja tha se ka vendosur që të flasë dhe, pasi ka një detyrim moral ndaj familjarëve të saj, të cilët u tronditën nga sulmi me breshëri kallashnikovi. Gazetarja Klodiana Lala thotë se ka vendosur të heshtë për gjatë këtyre gjashtë ditëve, për t'u dhënë kohë organeve të drejtësisë që të bëjnë punën e tyre. Ndonëse kanë kaluar gjashtë ditë nga sulmi, ende nuk ka një të dyshuar konkret për ngjarjen.

Pse vendose të flasësh sot Klodi, le ta nisim këtu?

Së pari, kam një detyrim moral ndaj familjes sime që është goditur në mes të natës me kallash. Kam një detyrim ndaj kolegëve të mi me të cilët punoj çdo ditë. Kam një detyrim ndaj opinionit publik që shpesh më ka mbështetur, por edhe kritikuar. Kur më ka mbështetur, më ka bërë të eci përpara, ndërsa kur më ka kritikuar më ka bërë të reflektoj për punën. Shumë më kanë thënë pse nuk reagoava në momentet e para. Nuk reagoava sepse duhet t'u lija institucioneve kohën e nevojshme të hetimeve. Këtë duhet ta bëjnë të gjithë, pra t'u japin kohë institucionëve për të bërë detyrën e tyre. Por në të njëjtën kohë unë jam e tronditur. Jam edhe sot e tronditur kur e mendoj se në banesën e prindërve të mi flinin dy vajzat e mija të mitura, të cilat pjesën më të madhe të viteve e kanë kaluar në atë banesë. E kalojnë aty, sepse unë kam zgjedhur amanet time si personin më të mirë dhe të përshtatshëm që të rrijë pranë tyre. Në momentet e para jam munduar të jem e fortë, sepse po të lëkundeshja unë, do të lëkundeshin edhe familjarët dhe nuk do ta mbanin presionin. Dhe për të gjitha këto arsye mendoja se do ishte më mirë një moment i dytë për të sqaruar opinionin publik, i cili ka bashkëpunuar me mua në momente të caktuara.

Na trego si ndodhi ngjarja, nga raportimet e asaj dite në mesazh me Klodiana Lala nuk ishte në banesë? Si u sinjalizove?

Është e vërtetë që unë atë ditë nuk isha në banesë, pasi



Gazetarja Klodiana Lala

jam ndodhur në apartamentin tim privat, që e kam në një zonë periferike. Atë ditë kam lëvizur shumë për shkak të një problemi shëndetësor familjar. Në banesë ishin dy prindërit e mi, babi është në prag të pensionit, janë ndodhur dy vajzat e mija të mitura, më e madhja është 6 vjeçe dhe e vogla 2 vjeçe. Është ndodhur vëllai im dhe një çift bashkëshortesh që janë miqtë të familjes sonë. Në mëngjes më telefonon vëllai dhe me thotë të hap "Whatsup"-in se më kishte sjellë një foto. Më besoni se gjithsecili që mund të jetë në vendim tim do tronditej. I jam lutur në telefon vëllait dhe i thashë unë e di që ti nuk ke probleme se të ndjej nga zëri, por më thua çfarë ka ndodhur me vajzat.

Foto çfarë tregonte, shenjat e plumbave në derën e shtëpisë?

U trondita kur pashë plumbat në muret e shtëpisë. Pasi u sigurova që vajzat dhe familjarët nuk kishin asgjë. Pyetja e parë ishte për vajzë sigurisht. Më pas kam pyetur për prindërit dhe miqtë që ishin atje. Pasi u sigurova që nuk kishte të lëndura, kam telefonuar drejtorin e policisë së Tiranës dhe më pas kam sinjalizuar me një mesazh edhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili u përgjigj në kohë rekord. Më ka marrë në telefon dhe policia shkoi në shtëpinë time. Unë ia kam bërë të qartë që unë nuk do publikoja lajm derisa të hetohej. Ne kemi qenë të hapur për t'u hetuar në të

gjitha pistat. Unë dhe familjarët nuk kemi asnjë problem të një karakteri të ndryshëm. Jemi të hapur për gjatë gjithë kohës dhe sigurisht do t'u japim institucioneve ligjzbatuese të gjithë kohën e nevojshme që të hetojnë lidhur me këtë gjë. Unë pasi e mora veten nga kjo tronditje, në kuptimin që e ndjeva të nevojshme që duhet të dal dhe t'i them opinionit publik që: Po, unë si nënë, si vajzë, si partnere, si motër jam e tronditur, por si gazetarë nuk jam e frikësuar. Unë në të gjitha vitet e mia të punës, 12 prej të cilave i kam pranë të njëjtës kompani, fillimisht në "Gazetën Shqiptare" e më pas në "News 24", jam për-

thirrje përmes televizionit ku unë punoj, që të hetojnë në të gjitha dimensionet, jo vetëm mua, por edhe pjesëtarët e familjes sime, përfshirë edhe dy vajzat e mia të mitura nëse është e nevojshme për ta bërë një gjë të tillë. A do ta kryej unë detyrën me të njëjtën përkushtim dhe a do frikësohem unë nga ky sulm?

E ke dëshmuar? Dje ishte live...

Unë kam dalë dhe live dhe sot e ndjeva po prapë të arsyeshme që t'i them opinionit publik që duhet të më besojë, ashtu sikurse më ka besuar për gjatë gjithë viteve të shkuara, që po, unë jam këtu, kam zgjedhur këtë vend të jetoj,

THIRRJA

Thirrja ime shkon për institucionet që të veprojnë sa nuk është vonë. Vetëm kështu opinionin publik nuk do të ketë frikë. Unë dyshimet e mia i kam për shkak të detyrës, por nuk do nxitohem për këtë gjë.

pjekur me të gjitha forcat dhe mundësitë që ta kryej detyrën time me profesionalizëm, me përkushtim, të jem e paanshme me të gjitha dhe t'u jap atyre mundësinë që të flasin për secilin histori. Sigurisht kam dyshime që kjo gjë dhe ky sulm lidhet direkt me punë time. Por, unë nuk do të nxitohem për ta thënë këtë gjë, do t'u jap të gjithë kohën e nevojshme institucioneve ligjzbatuese. Do të jem e hapur dhe u bëj

do vazhdoj të jetoj këtu, vajzat e mira do t'i rrit këtu, pasi është një vend që e kam dashur, e dua dhe do ta dua shumë. Dhe në këtë këndvështrim e ndjeva të nevojshme që të flas për familjen time dhe të gjithë opinionin publik.

Deri tani duket se është një kërcënim për çështje të punës, ndaj le të flasim pak për këtë fenomen, të gazetarit të kërcënuar. Dhe sidomos

KËRCËNIMI

"Para dy vitesh e gjysmë mua më është adresuar një tjetër kërcënim. Është një dosje, e cila vijon të jetë në Prokurorinë e Tiranës. Në atë kohë mua më erdhi një letër që më kërcënonte me jetën e familjarëve të mi. Kam shkuar në zyrën e Haki Çakos dhe më kanë dhënë mbrojtje në atë kohë. Nuk e kam bërë publike këtë çështje. Por që një gazetar ta bëjë mirë punën, duhet të jetë i sigurt për jetën e tij dhe familjarëve të tij.

momente të caktuara.

Qoftë edhe për një moment, si nënë, e ke menduar të largosh vajzat nga vendi, nga Shqipëria, pas asaj që ndodhi?

As edhe për një moment të vetëm, sepse unë besoj se nëse ne do jemi të gjithë bashkë e do bëjmë punën tonë dhe nëse institucionet zbardhin ngjarjet dhe vënë para drejtësisë njerëz që kryejmë krime, apo një sulm të tillë. Mund ta them, se ky është një sulm prej burracakësh, sepse të marrësh armë dhe të qëllosh në drejtim të dy femijëve të mitur është monstrooze. Dhe jo sepse më ka ndodhur mua, por kujto që t'i ndodhë, kushdo nënë që do ishte në vendin tim, pa diskutim që do thoshte të njëjtën gjë. Nuk e kam menduar dhe nuk e mendoj. Vajzat e mia i kam në kopsht dhe çerdhe publike, jam e hapur të hetohem nga të gjitha mediat. Nuk e di pse na qëlluan, unë jam përpjekur të jem korrekte në punën time. Ne kemi kemi dalë dhe kemi folur për ngjarje shumë të rënda, që ende nuk kanë një autor. Për pak ditë bëhen 9 vite nga ekzekutimi mafioz i gjykatësit Skerdilajt Konomi. Janë njerëzit e parë që kam menduar në momentin që u njoftova për ngjarjen, sepse një grua mbeti e ve me dy femijë të vegjël dhe as sot nuk e dinë arsyen përse femijët e saj porriten jetimë, përse bashkëshorti i saj gjykatës iu ekzekutua në mes të Vlorës. E shumë e shumë raste të tjera. Ndaj thirrja ime shkon për institucionet që të veprojnë sa nuk është vonë. Vetëm kështu opinionin publik nuk do të ketë frikë. Unë dyshimet e mia i kam për shkak të detyrës, por nuk do nxitohem për këtë gjë.

Sa larg kapjes së autorëve të ngjarjes janë institucionet?

Në fakt nuk kam pyetur, pasi do të konsiderohej intimitidim, duke qenë se unë jam palë e dëmtuar. Çka do të thotë se janë kolegë të tjerë që mund të merren me këtë ngjarje. Shqetësimet e mia i kam adresuar, tani po pres të flasin organet. Por nëse nuk do të gjenden autorët për ngjarjen, jo vetëm për këtë, por për çdo ngjarje, atëherë frika do të jetë shumë e madhe, mes gazetarëve dhe të gjithë qytetarëve.

LEZHE- Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mesditën e djeshme në zonën e Shënkollit në Lezhë. Konkretisht ngjarja është regjistruar te ura e Prekanit. Sipas informacioneve paraprake personi i plagosur është shtetasi Martin Doda. 34-vjeçari është transportuar me urgjencë në spitalin e Lezhës për të marrë ndihmën mjekësore. Në vendngjarje shkuan forca të shumta policore, të cilat bënë mundur identifikimin dhe shpalljen në kërkim të au-



Policia identifikon dhe shpall në kërkim autorët

Lezhë, plagoset me armë nga dy bashkëfshatarët 34-vjeçari Martin Doda

torëve. Mësohet se dy autorët e dyshuar të ngjarjes janë shtetasit me inicialet PLL, dhe Z.B., të dy banues në Tale. "Ditën e mërkurë, rreth orës 13:30, është marrë njoftim se në vendin e quajtur "Ura e Prekanit" në rrugën Kryqëzimi i Shënkollit - Tales, është plago-

sur me armë zjarri shtetasi M.D. 34 vjeç, banues në Tale, i cili është dërguar në spitalin Rajonal në Lezhë, për ndihmën e nevojshme mjekësore. Falë veprimeve të shpejta hetimore, u bë mundur identifikimi i autorëve të dyshuar shtetasve PLL dhe Z.B., të dy ban-

ues në Tale, të cilët u shpallën në kërkim dhe po punohet për kapjen e tyre", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, po punojnë për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

SHKURT

Sherri, vritet me thikë 13-vjeçari, kapet autori

Një fëmijë i mitur, rreth 13 vjeç, ka gjetur vdekjen pasditën e djeshme në Fushë Mamurras. Burimet paraprake për "News 24" raportuan se i mituri dyshohet se humbi jetën pasi u godit me thikë nga një bashkëmoshatar. Paraprakisht dyshohet se shkak është bërë një grindje mes tyre, megjithatë policia njoftoi se kishte arrestuar menjëherë autorin, i cili edhe ai është i mitur.

Dhunuan dy persona në Bulqizë, arrestohen autorët

BULQIZË- Dy persona kanë rënë në pranga, pasi akuzohen për dhunë. Ngjarja ka ndodhur në Bulqizë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Ruzhdi Rushiti, 24 vjeç, banues në Bulqizë dhe Dritan Taçi, 20 vjeç, banues në Tiranë akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë goditur me sende të forta shtetasit M.D. 54 vjeç. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për veprat penale "Plagosje e lehtë me dashje", "Shkatërrim pr-onë", kryer në bashkëpunim.

Dërgonin shqiptarë ilegalisht drejt Anglisë, 8 në pranga

Policia italiane shkatërroi një grup italo-shqiptar që dërgonte klandestinë shqiptarë drejt Anglisë. Mediat italiane raportojnë se 8 persona kanë rënë në pranga, mes tyre shqiptarë dhe italianë. Mësohet se grupi kishte ndërtuar një mekanizëm, ku dërgonte nga Italia drejt Anglisë shtetas shqiptarë ilegalisht, përmes pagesave. Në kuadër të operacionit të koduar "Tower Bridge" u bë e mundur që në Romë të arrestoheshin pjesëtarët e kësaj bande trafikimi. Ata akuzohen se kanë ndihmuar për emigracion të paligjshëm dhe falsifikim dokumentesh. Në aksionin në fjalë u përfshi edhe Policia Metropolitane në Londër. Deri më tani nuk dihen detaje nga operacioni në fjalë, si dhe identitetet e personave të arrestuar. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur janë zbuluar raste të tilla të këtyre skemave të trafikimit të klandestinëve.

Ndeshja Shqipëri-Izrael në Elbasan, shërbimet policore në gatishmëri

Ngjarjet kriminale në Shkodër policia, Renea e FNSH kontrole në lagjet problematike

Sekuestrohen makina të blinduara të familjeve Lici e Bajraj

Ina Allkanjari

Dy ditë pas deklaratës së ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili u shpreh se grupet kriminale do të goditen shumë shpejt, policia ka zbkruar në Shkodër. Ky qytet është rrethuar nga dhjetëra forca policie të ardhura edhe nga Tirana. Specialistë të forcave RENEA, FNSH-ja e Tiranës, Shkodrës bashkë me Forcat Shqiptare dhe struktura të tjera policore që në orët e para të mëngjesit të djeshëm kanë zbkruar në Shkodër duke vijuar kontrole në disa prej lagjeve të qytetit. Këto kontrole policore kanë nisur që në lagjen Rus për të vijuar në Kiras, zonën e Livadeve ku janë kryer një sërë krimesh si dhe në zonën e Dobraqit. Efektivë të maskuar dhe armatosur bashkë me blindat e policisë kanë vijuar pa ndërprerë këtë aksion në qytetin e Shkodrës, qytet i cili brenda 3 muajsh pati 6 vrasje të ndodhura bashkë me dy persona që rezultojnë të zhdukur që nga 23 gushti i këtij viti. Policia ka ushtruar këto kontrole jo vetëm në rrugë, por edhe dyqane, lokale dhe shtëpi të ndryshme. Nuk kanë munguar as snajperët të shpërndarë në pozicione të ndryshme në gjendje gatishmëria bashkë me ambulancën në rast të ndonjë situatë të vështirë të shkëmbimit të zjarrit. Ky aksion blic i policisë i iniciuar nga drejtorja e përgjithshme vjen menjëherë pas ardhjes së krerëve të opozitës në Shkodër dhe deklaratave të kreut të PD Lulzim Basha apo ish-kryeministrit Sali Berisha se qeveria ka rënë përballë krimit në qytetin e Shkodrës. Kontrollet janë bërë në mënyrë të intërishe duke u fokusuar kryesisht tek armët, mjetet e blinduara pa dokumentacionin përkatës apo edhe lëndë narkotike ose persona të rrezikshëm që mund të jenë prej kohësh në kërkim policor dhe deri më tani nuk janë arrestuar ende. Burime nga policia konfirmojnë se gjatë kontroleve janë sekuestruar 5 makina të blinduara, të cilat ishin në pronësi të familjeve Lici dhe Bajraj. Prania e këtyre forcave të shtuara të policisë në Shkodër është edhe si një mesazh për qytetarët që ata të mos ndjehen të frikësuar ndaj krimit, i cili në 3 muaj ka marrë 6 jetë



Aksioni i policisë në Shkodër

njerëzish dhe dy të tjerë të zhdukur. Këto aksione janë bërë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë ku vrasjet dhe terrori kanë njohur një rritje.

KONTROLLET NË ELBASAN

Porca të shumta policie kanë zbkruar edhe në një qytet tjetër problematik, pikërisht në Elbasan. Prej

DOM ARTUR JAKU

Prifti katolik i Shkodrës Dom Artur Jaku gjatë mesheh me rastin e ditës së Shën Terezës kërkoi t'u jepet fund krimeve në qytetin e tij. "Sot nuk e kam një apel për qeverinë, sepse ajo do të gëkohet ditën e zgjedhjeve, por e kam për ata që vrasin, marrin një jetë. Mos harroni ju mund t'i shpëtoni policisë, drejtësisë, mund të jeni të lirë pas një krimi, por mos harroni se ka një Zot që nuk fal marrjen e një jete"- shprehet ai.

mbrëmjes të së martës policia po ushtron kontrole të shumta në katër pikat kyçe të qytetit. Kjo pasi Elbasani është një qytet rreth i përfolur për kriminalitetin, bashkë me

Vlorën si zona me grupe kriminale. Prej kohësh Drejtoria e Policisë Vendore organizon kontrole të shumta për të garantuar rendin dhe qetësinë publike si dhe për zbulimin dhe goditjen e elementit kriminal. Duke qenë se Elbasani është një nga qytetet kryesore të vendit që lidhet nëpërmjet akteve më të rëndësishme rrugore me kryeqytetin, me Portin e Durrësit dhe me pikat kufitare me Maqedoninë e Greqinë e ka kthyer atë ndër vite në një rrugëkalim të paevitueshme të kontrabandistëve, trafikantëve dhe elementëve kriminalë duke e vënë policinë e Elbasanit para sfida të shumta. Gjithashtu, edhe qarkullimi i dendur i automjeteve dhe ngjarjet jo të pakta kriminale të viteve të fundit kanë bërë që Elbasani të jetë në fokus të punës së policisë. Aktualisht shërbimet policore janë në gatishmëri për shkak të ndeshjes Shqipëri-Izrael dhe po të kujtojmë ndeshjen e fundit për Europlanin, Policia e Shtetit dhe shërbimet sekrete kaluan në gatishmëri disa javë më herët. Sidoqoftë kohët e fundit situata e rendit dhe qetësisë është përmirësuar. Gjithsesi pritet që Porca e Ligjit të ketë rezultate konkrete pasi është deklaruar disa herë që është dokumentuar aktiviteti i disa elementeve kriminale. Ndërkohë FNSH-të dhe forcat e tjera të policisë po ushtrjnë kontrole të vazhdueshme ndaj mjeteve luksioze apo të dyshuara.

Ekzekutohet me armë 43-vjeçari shqiptar në Spanjë, pista e hetimit: Hakmarrja

SPANJE- Një shtetas shqiptar është ekzekutuar me armë zjarri gjatë mbrëmjes të së martës në Spanjë. Ngjarja ndodhi në lagjen 'La Pastoreta' në Tarragona. Mediat spanjolle raportojnë se viktima është 43-vjeçari shqiptar Fatmir A. Ai u gjet i vranë në mes të rrugës gjatë natës në Reus të Tarragonës. 'Okdiario.com' shkruan se 43-vjeçari shqiptar banonte në këtë zonë. Po ashtu mësohet se shqiptari ka qenë i dënuar për vrasjen e një personi në vitin 2008, ndërsa dyshohet se ng-

jarja ndodhi për prishjen e pazareve të drogës. Shërbimet e emergjencës rreth orës 00.45 u njoftuan se një person është gjetur i shtirë në rrugë dhe se kishte një plagë me armë zjarri (Dyshohet pistoletë). Sipas 'Diari de Tarragona', viktima u qëllua nga një makinë me xhama të errët, e cila më pas u largua menjëherë nga vendi i ngjarjes. Aktualisht po hetohet rreth zbardhjes së plotë të ngjarjes në fjalë ndërsa pista kryesore e hetimit është ajo e hakmarrjes.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me permbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 01.10.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitenje e pasurise te paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtësi me sipërfaqe 128 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jemaku me vlerë fillestare ne ankand 81,043 (Tetëdhjetë e një mijë e dyzet e tre) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me permbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 02.10.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shitenje e pasurise te paluajtshme. Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 630, volumni 9 , faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare ne ankand 25,200 (Njëzet e pesë mijë e dyqind) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

KOSOVE-SERBI BISEDIMET

Vuçiç para takimit në Bruksel: Prishtina, s'do të diskutohen çështjet thelbësore

Korrigjimi i kufijve, Thaçi: S'do diskutohet Mitrovica e Ujmani

Të premten takimi Kosovë-Serbi, pritshmëritë e dy presidentëve

Vetëm një ditë na ndan nga takimi i shumëpritur i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi me atë të Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Ndërkaq reagimet lidhur me diskutimin e shkëmbimit të kufijve nuk kanë ende të soshur. Ndërkaq dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka reaguar sërish në lidhje me shkëmbimin e territoreve apo, siç po e quan ai, "korrigjim të kufijve". Kreu i shtetit e ka cilësuar si të vetmen zgjidhje për ta përfunduar konfliktin në mes të Kosovës dhe Serbisë. Thaçi në një debat të thirrur nga Instituti Demokratik i Kosovës, me temën "Çfarë do të thotë korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?", tha se me këtë proces nuk do të ketë ndarje e as shkëputje të pjesës veriore. Thaçi mes të tjerash pohoi se në asnjë rrethanë nuk do të bisedohet për Ujmanin e as për qytetin e Mitrovicës, por se ky proces do të shënojë fundin e konfliktit të gjatë në mes të dy vendeve. "Njohja reciproke mund të përcillet me një proces të dakorduar të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por,

HASHIM THAÇI:


"Njohja reciproke mund të përcillet me një proces të dakorduar të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por, theksoj nuk do të ketë ndarje e as shkëputje të pjesës veriore. Nuk do të bisedohet kurrë në asnjë rrethanë as për Gazivodën e as për qytetin e Mitrovicës. Ky proces do të shënojë fundin e konfliktit e gjatë mes Kosovës e Serbisë, e jo siç thonë do të zgjojë konflikte. Fundi i konfliktit do të vijë duke bërë kufirin e qartë mes vendeve tona", -tha Thaçi.



theksoj nuk do të ketë ndarje e as shkëputje të pjesës veriore. Nuk do të bisedohet kurrë në asnjë rrethanë as për Gazivodën e as për qytetin e Mitrovicës. Ky proces do të shënojë fundin e konfliktit e gjatë mes Kosovës e Serbisë, e jo siç thonë do të zgjojë konflikte. Fundi i konfliktit do të vijë duke bërë kufirin e qartë mes vendeve tona", -tha Thaçi.

pyetur se si i komenton deklaratimet e fundit të Thaçit se nuk do të diskutojë as për liqenin e Gazivodës e as për veriun e Kosovës. Ai ka thënë se Ser-

bia nuk ka kohë për të humbur dhe se liderët e të dyja shteteve duhet të marrin përgjegjësi. Por ndryshe janë pritjet e Brukselit dy këtë takim ndërmjet dy presidentëve. Komisioneri Johanesh Hahn ka thënë se marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të arrihet deri në fund të këtij viti, ose më së largu deri në maj të vitit 2019. Kujtojmë se të martën koalicioni qeverisës në një seancë që është shtyrë disa herë radhazi si pasojë e mungesës së kuorumit dhe kushtëzimit të deputetëve të Listës Serbe, ka venë në rend të ditës votimin e grupit të unitetit për dialogun me Serbinë, që do të udhëhiqet nga Fatmir



Limaj. Këtë nismë sot e ka mbështetur edhe Thaçi, i cili ka thënë se do të bashkëpunojnë në përpunje me Kushtetutën e Kosovës. Seanca e koalicionit qeverisës është thirrur si kundërpërgjigje ndaj seancës së thirrur nga opozita ku pritet të miratohet një rezolutë që ia ndalon Thaçit të debatojë për kufijtë në dialogu e Brukselit.

Shaip Kamberi: Kosova duhet të kërkojë të pagjeturit

'Shkëmbim territori', Bujanovci del kundër idesë së Thaçit: Mos jepni Veriun për ne

Një reagim lidhur me shkëmbimin e territoreve e ka dhënë dhe kryetari i Komunitetit të Bujanovcit, Shaip Kamberi deklaroi se janë kundër shkëmbimit të territoreve me Serbinë. Sipas tij ideja e bashkimit me Kosovën po nxit emocione të banorët në Luginë dhe në këtë pikë të dialogut duhet të caktojë objektivat e veta. "Kur të del një ide atraktive se do të bashkohemi me shqiptarët, nxit emocione dhe shprehe, por ne nuk i përcaktojmë vijat e kuqe që Kosova i përcakton. Kosova duhet të përcaktojë cilat duhet të jenë objektivat e saj në këtë dialog. Kosova duhet të kërkojë të pagjeturit", -shtoi Kamberi. Mes të tjerash ai tha se ata nuk kanë kërkuar të japin Veriun dhe të marrin Luginën. "Ne nuk kemi thanë që ju jepni Veriun dhe merreni Luginën dhe nëse Bashkësia Kombëtare është e

pajtimt, Lugina e Preshevës ka vullnet të bashkohet me Kosovën dhe për neve nuk ka asnjë moment nuk kemi vullnet me e nda popullatën dhe cilat është më mirë për Kosovën le të vendos ajo vetë. Kosova e ka obligim kombëtar që Luginën e Kosovës e ka obligim të diskutojë nëse jo për shkëmbim territoreve atëherë për të drejtash. Kosova duhet të ketë përfundimisht duhet të vendosë kushte për këtë pjesë të dialogut. Ajo që askush në Luginë nuk e do shkëmbimin e territoreve, dhe kjo është shumë e dëmshme me ne, në këtë aspekt Kosova duhet të tregojë se cilat janë linjat e kuqe të këtij dialogu dhe në këtë rast vlen ajo shprehje "mos i beso grekut edhe kur sjellë dhuratat" dhe është Kosova është ajo që duhet të vendosë. Sipas statistikave ka rreth 62 për qind shqiptarë dhe 10 për qind rom dhe kemi në përgjithësi rënie të popullsisë dhe jo vetëm të asaj shqiptare", pohoi ai. Këto dek-

larata Kamberi i dha në tryezën "Loja me kufij, luftë apo zgjidhje në Ballkan?" do të diskutohet për qëndrimin e partive politike të Kosovës rreth kësaj ideje, koston e një opsioni të tillë për Kosovën si dhe të ardhmen e aseteve ekonomike e strategjike të Kosovës që gjenden matanë lumit Ibar. Folës në tryezën e moderuar nga Jeta Xharra do të jenë: Avdullah Hoti, shef i grupit parlamentar të LDK; Albin Kurti, kryetar i LVV; Shaip Kamberi, kryetari i Komunitetit të Bujanovcit; Fehmi Beja, kryetar i Komunitetit të Medvegjes; Nenad Rashiq, kryetar i PDP; Ahmet Isufi, nënkryetar i AAK-së, si dhe deputetë, ish-deputetë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Gjatë tryezës do të emetohen video të shkurta të pikëpamjeve të analistëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Europa e rajoni të dhëna ekskluzivisht për këtë tryezë.

Kryeministri i Greqisë: I konsiderojmë qytetarët tanë

Shpëtoi banorët nga zjarri në Mati, Tsipras i jep shtetësinë greke emigrantit hero shqiptar

Për kontributin e tyre që dhanë në ngjarjen tragjike të 23 korrikut, ku shpëtuan jetë njerëzish nga zjarri masiv në Mati, tre peshkatarëve të huaj që jetojnë prej vitesh në Greqi, do t'u jepet shtetësia greke. Ata janë një shqiptar dhe dy egjiptianë. Dje kryeministri Tsipras shkoi vetë në Mati, në periferi të Athinës, zona që u prek nga zjarri i madh ku vdiqën rreth 100 persona. Ai falënderoi emigrantët

e huaj, që së bashku me kolegët e tyre peshkatarë grekë shpëtuan dhjetëra jetë njerëzish. "Peshkatarët vendas dhe emigrantët, bënë një betejë heroike gjatë tragjedisë, duke shpëtuar jetë. Shteti e njeh sakrificën e tyre. Ne i falënderojmë", shkroi në Twitter kryeministri Tsipras. Ministria e Brendshme e Greqisë është angazhuar me procedurat për dhënien e shtetësisë së 3 emigrantëve të huaj, mes tyre një sh-

qiptar. Mediat vendase raportojnë se shtetësia greke për ta do të dalë për çështjet ditësh. Tre emigrantët, shqiptarë dhe dy egjiptianët, jetojnë dhe punojnë prej më shumë se 20 vitesh në Greqi. Gjatë takimit një ditë më parë me banorët e zonës që u prek nga zjarri, Tsipras tha se "këta njerëz i konsiderojmë qytetarët tanë" dhe kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në komunitet.



Thaçi për median franceze: Paqja mes Kosovës e Serbisë, e pashmangshme

"Le Figaro": Franca mbështet korigjimin e kufijve, Macron do bindë Merkelin

Një tjetër reagim ka ardhur edhe nga ndërkombëtarët lidhur me korigjimin e mundshëm të kufijve që do të bëjë Kosova me Serbinë ditën e premte kur do të kenë dhe takimin e tyre të radhës. E përditshmja prestigjioze franceze "Le Figaro" ka cituar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, shefin e stafit të tij, Bekim Çollaku, si dhe disa analistë francezë. Sipas "Le Figaro", Thaçi dhe Vuçiq nuk e pëlqejnë njëri-tjetrin, por kanë vendosur, që në emër të paqes dhe stabilitetit, të punojnë së bashku drejt pajtimit të popujve të tyre. "Nëse gjithçka shkon sipas planeve, Presidenti i Kosovës dhe Presidenti i Serbisë do të jenë në gjendje të konsolidojnë pajtimin e tyre deri në mes të nëntorit në Paris, në Forumin për Paqe, që do të organizohet nga Elysee", shkruan gazeta franceze. Njëzet vjet pas luftës, serbët në veri të lumit Ibër – lumi që ndan Mitrovicën në dy – ende nuk i njohin institucionet e Kosovës, pasi e konsiderojnë Beogradin si kryeqytetin e tyre. I njëjti tension mund të gjendet në jug të lumit. "Status quo-ja është e keqe për të gjithë", pranon Bekim Çollaku, shefi i stafit të Hashim Thaçit për mediumin francez. Sipas të përditshmes franceze, të dy presidentët megjithatë kanë një interes të përbashkët: të ecin më shpejtë, krah për krah, drejt integritetit evropian. Duke folur për qëndrimin amerikan, gazeta shkruan se John Bolton, këshilltari i sigurisë kombëtare, deklaroi në fund të gushtit se Uashingtoni nuk do të kundërshtonte rregullimet territoriale. "Franca është, gjithashtu, në favor të këtyre rishikimeve, siç është edhe Austria. Federica Mogherini është e gatshme të mbështesë atë që Presidenti i Kosovës paraqet thjesht si një korigjim territorial", shkruan gazeta "Le Figaro". Sipas një diplomati francez, ekziston një dritare e mundësisë përpara zgjedhjeve evropiane, por duhet të veprojme shpejtë. Në të vërtetë, zgjedhjet mund të rezultojnë që Komisioni të bëhet edhe më nacio-



"LE FIGARO":

"Nëse gjithçka shkon sipas planeve, Presidenti i Kosovës dhe Presidenti i Serbisë do të jenë në gjendje të konsolidojnë pajtimin e tyre deri në mes të nëntorit në Paris, në Forumin për Paqe, që do të organizohet nga Elysee", shkruan gazeta franceze.

se ky projekt është "sui generis". Ashtu siç ishte rasti me pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, projekti nuk synon të krijojë asnjë "precedent" brenda Ballkanit dhe as në rajonin e Kaukazit. "Serbia do t'i japë Bosnjës garanci për integritet. Por, e vetmja gjë që ka rëndësi për ne është gjetja e një zgjidhjeje paqësore me Serbinë", ka thënë Bekim Çollaku, shefi i stafit të Hashim Thaçit, përgjegjës për negociatat me Beogradin. Si në Prishtinë, ashtu edhe në Beograd, çështja mund të zgjidhet nëpërmjet referendumit. Por, për momentin jemi larg një konsensusi. "Ndonjëherë paqja bëhet më vështirë sesa lufta", -vazhdoi shefi i stafit të presidentit kosovar. Në shtetet e Ballkanit, tensioni mund të rritet shumë shpejt. Opozita radikale, e cila refuzon të bëjë koncesionet më të vogla për serbët, ka akuzuar Thaçin se është "tradhtar i kombit".

Kisha Ortodokse është akoma e lidhur me mitin themelues të Serbisë, humbjen e saj në betejën e Kosovës kundër Perandorisë Osmane dhe Kosova bëhet kështu për ta "vendlindja e kombit serb". Gazeta shkruan se Kisha Serbe është, gjithashtu, shumë e afërt me Kishën Ortodokse Ruse, e cila vetë është një aleat i ngushtë i Vladimir Putin. Kjo shtron pyetjen: si do të reagojë Kremli për këtë projekt, duke pasur parasysh se si Rusia refuzon tu njohë shteteve islamike të Rusisë atë që e mori me forcë kur aneksoi Krimenë nga Ukraina.

Dha lajmin para 2 ditëve, vdes prezantuesja e lajmeve

Rachel Bland, prezantuesja e lajmeve në BBC Radio 5 Live, u nda nga jeta këtë të mërkurë. Vetëm dy ditë më parë, 40-vjeçarja paralajmëroi se i kishin mbetur "vetëm pak ditë jetë", në një postim në rrjetet sociale. Bland kishin rreth 2 vjet që ishte diagnostikuar me kancer në gj. Sipas BBC, lajmi për vdekjen e prezantueses e konfirmoi familja e saj, e cila tha se 40-vjeçarja ndërroi jetë orët e para të së mërkurës. Bland ishte një zë i njohur në Radio 5 Live, si folëse lajmesh dhe prezantuese. Ajo u vlerësua me çmim për prezantimin e programit radiofonik mbi kancerin "You, Me and the Big C". Ajo e dokumentoi, gjithashtu, jetën e saj me sëmundjen vdekjeprurëse në një blog personal. Dy ditë më parë, në një postim në Twitter, Bland shkruajti: "Kam frikë se koha ime ka ardhur miqtë e mi. Dhe krejt papritur. Kam vetëm pak ditë jetë, është vërtetë surreale. Faleminderit shumë për të gjithë mbështetjen që më keni dhënë". 40-vjeçarja mbante mbi supe një karrierë mbi 15 vjeçare dhe kishte punuar për disa programe në rrjetin prestigjioz BBC. Ajo u diagnostikua me kancer në nëntor të vitit 2016, pasi gjeti një gjendër poshtë krahu.

Erdogan paralajmëron "masakër" në Siri

R Recep Tayyip Erdogan, presidenti i Turqisë, paralajmëroi se sulmi në provincën Idlib të Sirisë mund të shkaktojë "masakër". Komentet vijnë derisa forcat qeveritare siriene po përgatiten për një ofensivë të madhe në rajonin e fundit të kontrolluar nga rebelët. "Një masakër serioze mund të ndodhë nëse atje hidhen raketa", tha Erdogan. Ai po ashtu paralajmëroi për rrezikun që luftimet e rënda do të shkaktojnë fluks të madh refugjatësh në Turqi. Idlibi kufizohet me Turqinë dhe është enklava e fundit e madhe e mbajtur nga kryengritësit që luftojnë presidentin sirian, Bashar al-Asad, forcat ruse dhe iraniane. Këto të fundit kanë luajtur një rol të madh në mbështetjen e Assadit gjatë luftës në Siri. Mijëra trupa qeveritare dhe luftëtarë aleatë janë vendosur tashmë në zonat që rrethojnë Idlibin. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, po ashtu ka paralajmëruar Assadin dhe aleatët e tij kundër "sulmeve të pamatura" në Idlib.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS




NGËRÇI I KËMBËVE NDODH KUR MBYLLET ARTERIA

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E enjte 6 Shtator 2018



**KLAUDIA PEPA SHKËLQEN NË TAPETIN E KUQ
TË FESTIVALIT TË FILMIT NË VENECIA**



**Jonida Maliqi topless?
Këngëtarja i mahniti të gjithë**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Nard Ndoka "frymëzon" popullin: Tunduni, nxitoni se jemi vonë...
- Rishfaqet Jozefina Topalli, Rita Ndoci e nxjerr në publik
- Mbretëresha Elisabeta dhe çadrat e saj, një për çdo veshje
- Postimi i ish-ministres së Ramës: Asgjë nuk i shpëton syrit të popullit



Rrëfëhet vokalisti: Fryma në grup dhe eksperiencat në koncerte

XHIELDO HYSENI:

**Ju tregoj të fshehtat
e hitit me Çiljetën**

*"Kur vështirësinë e kthen
në forcë, je i pathyeshëm"*

Grëfhet vokalisti: Fryma në grup dhe eksperiencat në koncerte

XHIELDO HYSENI:

Ju tregoj të fshehtat e hitit me Çiljetën

"Kur vështirësinë e kthen në forcë, je i pathyeshëm"

Egla Xhemali

A i është një nga zërat më të dashur për publikun. Vokalisti simpatik i "Alar band" zbulon për "Summer Pages" të fshehtat e bashkëpunimeve të suksesshme, frymën në grup, si dhe zhanret, të cilat preferon t'i dëgjoj më tepër. Ky sezon veror ka qenë impenjativ, por mjaft i bukur për Xhieldo Hysenin, i cili është duke shijuar së bashku me grupin dhe Çiljetën suksesin e hitit "Bonbone". Ai pohon se kënga lindi në studio dhe erdhi shumë spontanisht ndërkohë që dëgjonin vijën melodike. Për djemtë e grupit Xhieldo na tregon se ata janë të zhurmsëm dhe rrëmujaxhinj, por kjo nuk i ndalon ata që të jenë miq shumë të mirë. Harmonia mes tyre është parësore dhe "Alar band-it" nuk i mungon ajo. Një eksperiencë e bukur ka qenë dhe bashkëpunimi me ambasadorin Donald Lu, të cilin Hyseni e ruan si kujtim të veçantë sidomos për batutat e shkëmbyera. "Amla" në bashkëpunim me Klea Hutën ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga këngët më të kërkuara në koncerte. Klea është shumë pozitive thotë vokalisti. Xhieldo dëgjon muzikë të rrymave të ndryshme, që varen nga gjendja emocionale në të cilën ndodhet. Për të muzika është qetësi e shpirtit. I pyetur nëse ka menduar të këndoje vetëm, Hyseni pohon se nuk e ka menduar pasi punon edhe në një zhanër tjetër në "TOB", në muzikën operistike. Për këngëtarin suksesi më i madh është që të bësh atë që do më tepër: Sipas tij, ngelesh i pathyeshëm kur vështirësinë e kthen në forcë. Ne urojmë që shumë shpejt të vijmë



hite të reja nga grupi 'Alar band' dhe të rezultojnë kaq të suksesshme sa këngët e lançuara.

Ç'loj bonboneje është Çiljeta?

Çiljeta është pa dyshim bonbone e ëmbël si sherbeti. Përpos pjesës që është një këngëtare e zonja ajo është dhe artiste në shpirt. Nuk ka më bukur se sa kur këto cilësi bëhen bashkë.

Si lindi teksti i këngës "Bonbone"?

Teksti i këngës "Bonbone" lindi në studio duke kënduar vijën melodike. Pastaj vumë të gjithë nga pak fjalë dhe vulën e vendosi Klea Huta me vargje pikante. Deri më tani bashkëpunimi me të ka rezultuar tejet i suksesshëm. Kënga dëgjohet ngado, pasi dhe ritmi i shkon përshat ditëve të nxehta.

Shkurt, si do të na i prezantoje djemtë e grupit tënd, "Alar band"?

Djemtë e grupit janë të zhurmsëm, transmetojnë shumë alegrë, por janë edhe të rrëmujshëm; nuk lënë dy gur bashkë me pak fjalë. E

rëndësishme është që jemi miq shumë të mirë. Harmonia në grup është mjaft e rëndësishme. Unë jam i lumtur që ne e kemi atë.

Çfarë ju tremb nëse merrni një vajzë "me kohë të plotë" në grup?

Në fakt, asgjë nuk më tremb pasi çdo njeri, aq më tepër në grup ka rëndësinë e përgjegjësitë e veta. Besoj që do dojë shumë kohë për

t'u ambientuar. (qesh)

Çfarë veprimesh bëni para se të dilni në skenë?

Shumë ujë normal dhe vokalica, gjimnastika e çdo këngëtar i jo vetëm para se të dalë në skenë, por çdo ditë kjo është palestra jonë.

Kush ju bën më shumë kritika dhe për çfarë?

Gjyshja është kritikja ime më e madhe, që nuk mendoj



se do të gjejmë ndonjëherë paqe, por normal gjithmonë ka diçka për t'u përmirësuar dhe unë i mirëpres të gjitha kritikikat. Çfarë batutash kishit me ish-ambasadorin Donald Lu gjatë bashkëpunimit në këngën e fundviti?

Një "ves" i yti për të cilin vajzat të duan shumë?

Në fakt, nuk kam ndonjë ves të veçantë.

Për çfarë nuk duhet të bësojmë kurrë?

Për të gjithë këtë intervistë që, sapa dhashë asgjë nuk është siç duket bëj shaka.(qesh) Unë mendoj që nuk kam asgjë për të mos u besuar për sa kohë jam i vërtet pa u shtirur.

Një listë të shkurtër me këngët që dëgjon me shumë dhe pse kjo zgjedhje?

Në fakt, unë dëgjoj muzikë sipas gjendjes emocionale, por padyshim dëgjoj muzikë klasike, jazz, blues, rock and roll.

A ke menduar ndonjëherë të këndosh vetëm?

Nuk e kam menduar, sepse unë jam solist në "TOB", por këndo në një tjetër zhanër muzikor në atë të muzikës operistike. Puna në grup është shumë e bukur dhe e vështirë, por kur vështirësinë e kthen në forcë je i pathyeshëm.




JONIDA MALIQI TOPLESS? KËNGËTARJA I MAHNITI TË GJITHË

Ajo gjithmonë ka tërhequr vëmendje me stilin e saj mjaft të veçantë dhe të guximshëm. Këngëtarja Jonida Maliqi asnjëherë nuk është dukur e njëjta, pasi ndryshon shpesh pamje. Çdo model apo ngjyrë flokësh asaj i shkon përshat. Me anë të një fotoje ajo ka pyetur fansat se kush gjendet në imazhin ku shfaqet 'topless'. Me flokët bionde dhe të shkurtër Jonida vështirë të njihet. Këto foto të realizuara nga këngëtarja kanë befusuar tërësisht.



KLAUDIA PEPA SHKËLQEN NË TAPETIN E KUQ TË FESTIVALIT TË FILMIT NË VENECIA

Këtë vit mbahet edicioni i 75-të i Festivalit të Filmit në Venecia, i cili do të zgjasë deri në 8 shtator. Shumë personazhe të njohur botëror, aktor të Hollywood-it e jo vetëm kanë parakaluar në tapetin e kuq. Ndërkohë që çdo ditë personazhe të rinj parakalojnë në tapetin e kuq, ka qenë radha e të vetmes shqiptare të ftuar atje, balerinës së njohur Klaudia Pepa. Ajo, në fakt, ka shkëlqyer me look-un saj duke lënë të habitur edhe të pranishmit. Klaudia kishte zgjedhur një fustan të gjatë me dy të çara anash, të cilat tregonin këmbët e saj seksi. Fustani ishte i mbyllur në pjesën e sipërme dhe në qafë kishte një fjongo. Pepa kishte zgjedhur një palë këpucë ngjyrë nude, të cilat i shkonin shumë fustanit. Bukuroshja i mahniti të gjithë me sensualitetin dhe sharmin e saj.




KUSH DO E PREZANTOJË "JO VETËM MODË"?

Pas largimit të moderatores Nevina Shtylla nga ekrani i Klan nuk dihet se cila moderatore do të zërë vendin e saj në prezantimin e emisionin "Jo vetëm modë". Qarkullon lajmi se do të jetë pikërisht bukuroshja Orinda Huta. Moderatorja është parë shpesh këto ditë në "Klan" ku përveçse do të jetë anëtare e jurisë së të rinjve në "Kënga Magjike" i është besuar edhe ky format televiziv. Ndërkohë mësohet se Nevina Shtylla do të jetë në "Top Channel". Kujtojmë se vite më parë Orinda ka qenë autore e emisionit "Next", ku Nevina ka qenë prezantuese për disa sezone.



LUANA VJOLLCA 'THYEN' KUFIJTË, FAMA E SAJ ARRIN DERI NË AZI

Që Luana Vjollca është një nga moderatoret më të famshme në Shqipëri kjo nuk ka asnjë dyshim. Përveç suksesit në televizion ajo është e suksesshme dhe në muzikë. Projektet e saj të fundit numërojnë miliona shikime në kanalën muzikor Youtube. Së fundmi, fama e saj ka mbërritur deri në Azi. Mediat vendase shkruajnë shumë për të duke e prezantuar si një femër shumë të bukur dhe energjike. Luana ka dhënë një intervistë për një nga mediat e njohura në Nepal, shtetin që ndodhet në Azinë Jugore. "Luana Vjollca është një personalitet shqiptar. Znj. Luana është një prezantuese karizmatike, e njohur për bukurinë dhe energjinë e saj, duke u kthyer në një shembull që puna vlerësohet. Luana nuk është vetëm në listën e më të kërkuarave në biznesin televiziv si një moderatore dhe producente, por, gjithashtu, është një këngëtare shumë e njohur, modele dhe një mbretëreshë e medias sociale", - shkruan "kathmandutribune.com". Madje e njëjta media ka bërë një listë me gjërat karakteristike për moderatoren Vjollca.





Është me rëndësi të madhe edhe ndërprerja e pirjes së duhanit, sepse është konstatuar që duhani përshpejton dhe përkeqëson arteriosklerozën dhe domosdo çon në komplikime, nga të cilat më i vështiri është shfaqja e gangrenës.



Tendosja apo ngërçi në pulpën e nëngjurit, që mund të përhapet edhe në kofshë, shpesh tregon ngushtimin kritik apo mbylljen e tërësishme të arteries së këmbës. Kohë pas kohe tendosja ose ngërçi në pulpën e nëngjurit, mund të shfaqet për shkak të mungesës së mineraleve në trup.

Tendosja apo ngërçi në pulpën e nëngjurit, që mund të përhapet edhe në kofshë, shpesh tregon ngushtimin kritik apo mbylljen e tërësishme të arteries së këmbës.

Kohë pas kohe tendosja ose ngërçi në pulpën e nëngjurit, mund të shfaqet për shkak të mungesës së mineraleve në trup, më së shpeshti për shkak të djersitjes së tepërt, por shpesh tregon edhe ngushtimin kritik por edhe mbylljen e plotë të arteries së këmbës.

Vendi i tendosjes, përkatësisht i dhembjes, tregon që problemi me siguri është në arteriet e kofshës, por mund të ekzistojnë edhe ngushtim i arterieve në gilca apo në komblik, përkatësisht në bark.

Në këtë rast është i domosdoshëm kontrolli, i cili nënkupton preken e pulseve në këmbë dhe përcaktimin e pranisë ose mungesës së ndryshimeve në lëkurën e shputave për shkak të ishëmisë.

Pastaj pason përcaktimi i indeksit kolor-dopler, me të cilin përcaktohet raporti i shtypjes së gjakut në këmbë dhe i shtypjes së gjakut në duar, të cilin mjekun e orienton se në cilën masë organizmi nuk ka mundur që nëpërmjet enëve të vogla të gjakut të sigurojë furnizim të këmbës me



gjak.

Pas kontrollit, mjeku vendos a është e nevojshme të bëhet menjëherë angiografia apo incizimi i enëve të gjakut me kontrastin dhe të ndërmarrë disa nga metodat e rivaskularizimit, siç është vendosja e stentës apo bypassit.

Në rastin kur përcakton që nuk ka ngushtim kritik të enëve të gjakut, re-

Ngërçi i këmbëve ndodh kur mbyllet arteria



komandon shërimin me barna.

Është shumë me rëndësi edhe ecja e përditshme, madje përtej kufijve të dhembjeve, sepse përmirë-

son qarkullimin e gjakut.

Është me rëndësi të madhe edhe ndërprerja e pirjes së duhanit, sepse është konstatuar që du-

huni përshpejton dhe përkeqëson arteriosklerozën dhe domosdo çon në komplikime, nga të cilat më i vështiri është shfaqja e gangrenës.

Nard Ndoka "frymëzon" popullin: Tunduni, nxitoni se jemi vonë...

Kryetari i Partisë Demokratike, Nard Ndoka, i dalë deputet nga lista shumë-mërore e PD, ka bërë thirrje në drejtim të shqiptarëve që të hidhen kundër qeverisë. Ndoka shprehet se tashmë është koha për t'i venë vize qeverisë e Kuvendit. Njëherësh kreu demokristian i ka kërkuar popullit të "tundet dhe të lëvizë", ndryshe kjo qeveri po i vë vizën e zezë këtij vendi. "Opozita e Bashkuar" vendosi në Shkodër vijën e kuqe në letër, koha për t'i venë vize qeverisë e Kuvendit! Tunduni o popull, nëse nuk lëvizim shpejt e fort, kjo qeveri po i vendos vijën e zezë këtij vendit!", shprehet Ndoka.



Rishfaqet Jozefina Topalli, Rita Ndoci e nxjerr në publik



Pas një mungese të gjatë në publik, është shfaqur ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli. Ka qenë artistja shkodrane, Rita Ndoci, e cila ka publikuar foto në rrjetet sociale në krah të Topallit. Ndonëse pa poste në politikë, Jozefina Topalli vijon të jetë aktive me komentet e saj, si një nga kritikët më të ashpra të Bashës. Ndërsa vetëm pak ditë më parë, e tronditur nga ngjarjet në Shkodër, ish-kryetarja e Kuvendit u shpreh se situata të tilla nuk kanë ndodhur kurrë në qytetin e saj.

BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozitet! 🤔

Mbretëresha Elisabeta dhe çadrat e saj, një për çdo veshje



Mbretëresha Elisabeta ka një koleksion të madh çadrash, të cilat i përdor me veshjet e saj sipas ngjyrës, gjatë eventeve zyrtare. Ndryshe nga Kate Middleton dhe Meghan Markle, fashionistja e vërtetë ikonë mbetet ajo, sovranja, që në moshën 92-vjeçare dhe 66 vjet në fronin mbretëror anglez nuk gabon asnjëherë me veshjen. Kostumet e saj me ngjyra janë zgjedhur me kujdes për të garantuar gjithmonë tërheqjen e publikut. Por ka një detaj të veçantë në veshjet e saj që bie në sy. Çadrat janë gjithmonë në koordinuar me veshjet në rastet kur bie shi. Modelet e zgjedhura nga mbretëresha, transparente dhe me konture me ngjyra kushtojnë 20 paund. Në këtë foto galeri janë disa nga çadrat e përdorura nga mbretëresha Elisabeta.

Postimi i ish-ministres së Ramës: Asgjë nuk i shpëton syrit të popullit

Ish-ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit në qeverinë "Rama 1" ka shpërndarë një video të rrallë të Shqipërisë komuniste. Behet fjalë për një videopërgjim të vitit '66, ku Sigurimi i Shtetit ndjek dhe përgjion gruan e ambasadorit të ish-Jugosllavisë në Shqipëri duke kryer "kontrabandë" me mallra të huaja. "Asgjë nuk i shpëton syrit të popullit. As asokohe, jo më tani", shkruan me humor ish-ministria Harito.



BOTIMI

Të bashkëjetosh pa frikë me një të huaj

Nga VASILIKA TAFA*


Frika erdhi papritmas dhe, me sa duket, pa ndonjë shkak. Në fillim ajo nuk ekzistonte tek unë, por më pas u bë dimension i im i ri. Më kot përpigëm të gjej nga se u shkaktua... kështu fillon romani "Amerikë '62" - de profundis" - i shkruar bashkëkohor qipriot Panos Ioannides, i përkthyer nga Kleo Lati dhe i botuar nga Shtëpia e librit OMBRA GVG. Nëse me romanin e parë, "Korbi", lexuesi shqiptar kishte njohur stilistikën e mrekullueshme të një shkrimtari të madh, romani "Amerikë '62" vizaton profilin e humanistit dhe intelektualit të angazhuar në mbrojtjen e identitetit dhe marrëdhënieve të komunikimit midis dy etnive, një populli që për shkak të gjeopolitikës është i detyruar të jetojë "i ndarë". Frika mbetet ende pezull dhe përcaktuese në marrëdhëniet katër mijëvjeçare midis pakicës me popullsi turke dhe pjesës tjetër të besimit të krishterë, në Qipron e vogël ishullore por me histori rrëzëluese, duke vizatuar me detaje edhe tiparet e një bote konfliktuale.

Është tetori i vitit 1962. Gazetarit qipriot Petro Arkondidhi, i akordohet një bursë nga Universiteti i Sirakuzës në Nju Jork, ku gazetarë nga shumë vende të ndryshme të botës ndjekin të njëjtin program. Mes tyre është Mehmet Riza Ozgul, gazetar turk. Por pavarësisht tensioneve politike mes Greqisë dhe Turqisë, pavarësisht fyerjeve midis grekëve të krishterë dhe turqve myslimanë, Arkondidhi dhe Ozguli bëhen miq të mirë.
Për Petro Arkondidhin, ky udhëtim drejt një "bote të re" është i rëndësishëm. Ambientet në të cilat i nevojitet të qarkullojë gjatë qëndrimit në Amerikë, njerëzit me të cilët takohet, situatat komplekse me mundësitë dhe pamundësitë që i duhet të përballojë si një *Odise i kohëve moderne*, janë përcaktuese dhe me ndikim edhe në formimin dhe fatin e tij. Krahas së vërtetës ku para syve të tij Amerika ngrihet me madhësi, në brendësi konstaton një botë thuasht të rrënuar. Autori i vendos ngjarjet në fillimin e viteve '60, kohë kur në historinë globale shfaqen shumë

kontradikta të mëdha. Në sfondin e këtyre kontradiktave është edhe kriza raketore kubane. Krizat që ka filluar të përjetojë kontinenti i madh, janë shumë më të rënda dhe më komplekse, krahasuar me konfliktet që ndodhin në Qipron ishullore rreth gjashtëmijëvjeçare, prej nga vijnë edhe protagonistët e romanit. Edhe pse me një periudhë katër mijëvjeçare të sundimit osman, ajo çka njihet si ngjarje kulmore në historinë e këtij vendi me popullsi të krishterë dhe myslimane është krijimi i republikës së pavarur nga vendet amë, duke sanksionuar edhe me kushtet e bashkëjetesës për pakicën turke dhe krijimin e një identiteti gjithëpërfshirës dhe të përbashkët qipriot.

"Amerikë '62" - de profundis", i quajtur edhe si *roman udhëtimi*, bazohet në shënimet që Ioannides kishte mbajtur midis tetorit 1962 dhe majit 1963 gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, një kohë që është ngjeshur në kujtesën e milionave njerëzve nga kriza kubane, e cila e shtyu botën deri në pragun e një lufte bërthamore.

Romani rrëfen se si historia dhe biografia e personazheve kryesore ndikojnë reciprokisht tek njëri tjetri. Qiprioti Petro Arkondidhi dhe turku Mehmet Riza Ozguel, që u takuan rastësisht në Universitetin e Sirakuzës, pavarësisht tensioneve politike midis Greqisë, Qipros dhe Turqisë, bëhen miq dhe ndërtojnë ura komunikimi dhe harmonie që i kapërcejnë pakënaqësitë tradicionale midis grekëve të krishterë dhe turqve myslimanë. Rastësia për të ndarë dhomën e hotelit bashkërisht është edhe një shans për të përjetuar reciprocisht ndjenjën e të jetuarit me një të huaj. Petro, i biri i të emigruarve nga Azia e Vogël, gjen tek Mehmeti "mikun e tij të betuar" dhe ky i fundit sheh tek Petro "grekun human". Ngjarja e cila zhvillohet në Amerikë,



pikëtakon me kohën kur në Qipron me klimë të nxehtë politike për shkaktuar nga nacionalizmi etnik, edhe pse u ndërpre për kohësisht në vitin 1960 kur u themelua Republika, është faksimil i një solidariteti human dhe shoqëror, pa të cilin të dy personazhet nuk do të mund ta kishin përballuar *amerikanizmin*, siç e shpreh edhe vetë Mehmeti në roman. Është "ëndrra e madhe amerikane" ajo që ndikon në botët shpirtërore të personazheve, me shpirtin e pazakontë. Të ndërgjegjësuar për vetminë dhe të qenit të huaj në kontinentin e madh, ata hedhin pas krahëve armiqtë e vjetër të kombeve, duke i qëndruar në çdo vështirësi më pranë njëri-tjetrit, aq sa edhe vetë nuk e besojnë se si ka nisur të funksionojë kjo lidhje harmonike.

Veç të tjerave, Petro Arkondidhi udhëtimi në Shtetet e Bashkuara i ka zgjeruar horizontin dhe e ka bërë që të pranojë pafundësinë e mundësive që garanton një bote e ndryshme nga ishulli, duke pranuar njëkohësisht se ruajtja me fanatizëm e modeleve të vjetruara, përballë përfuturit të mentalitetit dhe përvojave të reja, përfundon në konflikt intensiv. Nga ky këndvështrim janë fokusuar edhe në roman situata e lufës së ftohtë, problemet e Qipros dhe kriza e Kubës, të cilat i "politizojnë" ndërveprimet e personazheve, duke shërbyer si rregullator i



"Amerikë '62" - ose romani ikonë i Panos Ioannides mbi bashkëjetesën fetare

raporteve mes njëri-tjetrit dhe vende të origjinës.

Ioannides në vitin 2003 ishte duke punuar për një roman autobiografik. Duke shfletuar shënimet që

mbante të mbyllura në sirtar prej dyzet vitesh, zbuloi ngjarjet dhe përvojat e dokumentuara që siç e ka vënë në dukje edhe në parathënien e romanit, "që edhe pse kishin kaluar kaq

Nikosia nga shtëpia botuese e mirënjohur "Armida Publication". Përveçse në Qipro, kjo veper është botuar në Gjermani, Turqi, Arabi, Amerikë dhe në disa gjuhë të tjera.

Panos Ioannides, i lindur në Amohosto vitin 1935, që nga moshë 20-vjeçare ka publikuar proza dhe teatro. Optika e problemeve në veprat e tij është identiteti qipriot. Si dëshmitar bashkëkohor dhe aktor gjatë luftës së çlirimit anticolonial, ngritjes së Republikës së pavarur, luftës civile me pakicën turke, pushtimit dhe okupimit i një të tretës së vendit nga Turqia, Ioannides ishte dhe është një mbrojtës i pathyeshëm i dialogut mes grekëve dhe turqve, të krishterëve dhe myslimanëve.

Vepra e tij letrare dhe funksionet e tij politik kulturor (ai është drejtor i programit të Korporatës së Transmetimit të Qipros dhe kryetar i Qendrës PEN të Qipros) kanë shtuar në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin e vetë konceptimit demokratik, pluralist dhe global të shoqërisë bashkëkohore, në pjesën e lirë të Qipros. Ato rrëfejnë mbi rrugëtimin e tij nga një luftëtar anticolonial në një avokat drejt integritimit, ato janë mesazhe harmonie që ngrihen mbi rrënojat e një epike ndarjeje, përjashtimi dhe gjenocidit kulturor etnik.

***Drejtoreshë e Shtëpisë së librit OMBRA GVG**

Flaka Haliti Këtu – apo atje, është më atje


"Këtu - apo atje, është më atje": ky titull i pavendosur i ekspozitës së Flaka Halitit në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë sugjeron një skepticizëm të përgjithshëm ndaj përkufizimeve të ngurta mbi hapësirën. Destabilizimi i tipareve të territorit, e sidomos i dikotomisë mes Lindjes dhe Perëndimit është karakteristikë e punës së artistes. E konceptuar si pasqyrë e punës së Halitit në këto pesë vitet e fundit, ekspozita e parë personale e saj në Shqipëri është një përzgjedhje punësh, që në mënyrë të vazhdueshme transgresojnë kufijtë fizikë



shumë vite, nuk kishin humbur asgjë nga vitaliteti dhe rëndësia e tyre". Procesi i shkrimit të kësaj vepre zgjati rreth katër vjet, dhe në vitin 2008 u botua dhe u hodh në qarkullim në

dhe mendorë. Punët e saj shumështruese vënë në lojë dhe sfidojnë marrëdhëniet e pushtetit si dhe nomenklaturën që sundon mbi sistemin e artit dhe më gjerë. Ato jo vetëm që refuzojnë klasifikimet tradicionale sipas mediumit, siç është skulptura, piktura, vizatimi apo fotografia, por ato sfidojnë edhe përfundimet e nxituara estetike, që janë pasojë e mendimeve cliché mbi një generatë, gjini apo përkatësi. Duke zhvendosur format e zakonshme, ajo duke animuar regjistrime që vijnë nga kontekste të veçanta politike dhe nga sfera të ndryshme të botës mondane

PËRVJETORI



Një kryq, një libër e një peshqir, sendet personale të Nënë Terezës

Fatmira Nikolli

Një libërth lutjesh me një shënim në anglisht të shenjttores, libri i homazheve në ambasadën shqiptare në Vatikan, rruzarja në një ngjyrë rozë të ëmbël, një ujëbëko-rë e thjeshtë e gdhendur, një kryq mbajtur prej saj dhuratë nga Papa Gjon Pali. Objektet kanë qenë pjesë e fondit të Muzeut Historik Kombëtar, si Krishti i kryqëzuar, rruzarja peshqiri a mësalja, pjata, gota e ujit, luga, piruni dhe thika që ka përdorur Nënë Tereza gjatë qëndrimit në shtëpinë e Z. Tonin Shpati etj.

Me rastin e 2-vjetorit të shenjtërimit të Gonxhe Bojaxhiut - Shën Tereza, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup organizuan promovimin e librit "Familjet katolike shqiptare në Shkup" të autorëve: Skënder Asani, Albert Ramaj



Ekspozita për shenjtoren dhe një libër për shqiptarët e Shkupit

dhe Natasha Didenko, si edhe ekspozitën "Jeta përmes kujtimeve".

Në promovimin e librit, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, tha se është kënaqësi përurimi i ekspozitës "Jeta përmes

kujtimeve" dhe të promovimit të librit "Familjet katolike shqiptare në Shkup" të autorëve Skënder Asani, Albert Ramaj dhe Natasha Didenko. Sipas tij, nëpërmjet botimit të librit "Familjet katolike shqiptare në Sh-



kup", autorët e librit, duke përdorur fakte dhe burime të vërteta historike synojnë të pasqyrojnë historinë e familjeve katolike shqiptare të Shkupit, të cilat gjithnjë e më tepër po mbulohen nga pluhuri i harresës. "Historia e familjeve të shquara qytetare të Shkupit asnjëherë nuk mund të tjetërsohet, asnjëherë nuk mund të asimilohet, sepse me kalimin e viteve do të lindin pinjollë të tjerë të shquar, të cilët do ta ngrenë edhe më lart emrin e fisit", tha Koçi. Ai vërejtë se pikërisht ky është edhe misioni historik që ka ndërmarrë Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup: të kultivojë traditat e bukura të trashëgimisë sonë kulturore jo vetëm tek shqiptarët që jetojnë në Shkup, por edhe më gjerë.

"Muzeu Historik Kombëtar, si institucion i kujtesës kombëtare dhe përçues vlerave të trashëgimisë kulturore në rajon e më gjerë ka organizuar veprimtari të shumta për nder të Shën Terezës, duke vënë në dukje vlerat humane dhe mesazhet që ajo i ka dhënë njerëzimit. Ekspozitat që kemi organizuar çdo vit në muajin shtator janë pritur me interes të veçantë nga vizitorët vendas dhe ata të huaj. Por edhe këndi i Shën Terezës në katin e dytë të Muzeut Historik Kombëtar, me objekte dhe sende personale të shenjttores me origjinë shqiptare paraqet një interes të veçantë", përfundoi drejtori Koçi në hapjen e ekspozitës "Jeta përmes

kujtimeve".

Promovimin e librit "Familjet katolike shqiptare në Shkup" dhe ekspozitën "Jeta përmes kujtimeve" e përshëndeti edhe drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Dr. Skënder Asani, i cila tha se shenjtoria Shën Tereza është personaliteti që i ka kaluar të gjitha kufijtë e vetëmohimit, duke u shërbyer të tjerëve për çka ajo mund të quhet "Nëna e dashurisë". "E filluam këtë aktivitet në Nju Jork, pastaj në Prishtinë dhe stacioni i fundit i misionit tonë është Muzeu Historik Kombëtar, që përkon me 2-vjetorin e shenjtërimit të Saj. Si autor i librit deklaroi se me botimin kemi bërë shumë pak, Nënë Tereza nuk mund të bëhet nënë biologjike, por u bë nënë historike e gjithë botës. Ne sot mundemi që të jemi bijtë e saj. Jam tejet i gëzuar që vij në Muzeun Historik Kombëtar por edhe si drejtor, edhe si studiues, sepse Muzeu Historik Kombëtar përmbledh të gjithë trashëgiminë tonë kulturore", tha Asani.

Ekspozita "Jeta përmes kujtimeve" flet për familjet katolike në Shkup, të cilat përmblajnë fotografi, fakte e dokumente. Në këtë ekspozitë një kënd i veçantë iu dedikua punimeve mbi figurën e Shën Terezës të nxënëseve të shenjttores me origjinë shqiptare paraqet një interes të veçantë", përfundoi drejtori Koçi në hapjen e ekspozitës "Jeta përmes

të konsumit, Haliti u jep imazheve, objekteve dhe materialeve ekzistuese një zë alternativ. Kjo qasje e saj prodhon kompozime të reja apo ende të padefinuara, që shpallosin marrëdhënie dhe ndërvarësi të pazakonta mes komponentëve të tyre heterogjenë.

Një perde transparente, të cilës i ndryshojnë ngjyrat, që siç thotë edhe titulli, "rri varur kot" (just hanging around) - këtu, apo atje - e ndërpret në mes korridorin linear me qëndrimin e vet përtaq-cool-kritik. Banerë të ngjyrosur me sprej, të pezulluar nga ekzistenca e tyre e përditshme fantazmagorike, i drejtojnë vizitorët nëpër hapësirat gjarpëruese. Elementet arkitekturalë, që duken si muret mbrojtëse që dikur rrethonin ndërtesat e OKB-së dhe NATO-s në Prishtinë, rrinë të shtrira në një gjendje letargjike, tashmë pa as edhe një funksion. Një robot me krahë i ndërtuar nga mbetjet e kampeve ushtarake të NATO-s në Kosovë ngjan si mishërim i dëgjave mes njëngjelli të historisë dhe një lajmëtarë me in-

teligencë artificiale nga e ardhmja. Dhe përdërisa publiku përballat me retë-si-fytyra që duken si shembëlltura të vetëkrijtuara, një personazh enigmatik me emrin "Joe", na del para krejt papritur, në forma të ndryshme antropomorlike në fshingjer-mermeri, ndërsa një trup tjetër abstrakt kryqëzon gishtat pas shpinës.

Duke refuzuar status quo-në e objektit, Haliti përballat me të kaluarën dhe me të ardhmen potenciale të tij, duke e hapur fushën e mundësive dhe perspektivave që tejkalojnë nocionet e thjeshta të përkatësisë. E gjithë hapësira e ekspozitës ngjan si një shfaqje e inskenuar, ku potenciali i fshëhur performativ i veprave vihet në jetë nga vetë imagjinata që nxit tek publiku.

"Këtu - apo atje, është më atje" është prezantuar për herë të parë në Kunststhalen Lingen (14 tetor, 2017-14 janar, 2018) dhe më vonë në Kunsthaus Hamburg (20 mars-20 maj, 2018). Ekspozita në Tiranë është kuruar nga Leonie Radine.

Flaka Haliti ka lindur në vitin 1982 në Prishtinë, Kosovë dhe jeton në Mynih, Gjermani. Pas diplomimit në Grafikë, pranë Fakultetit të Arteve në Prishtinë në vitin 2006, ajo vazhdoi studimet për Artet e Bukura në Städelschule në Frankfurt mbi Main nga viti 2008 deri në vitin 2013. Aktualisht ajo është duke bërë doktoraturë në praktikë pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Vjenë. Punët e saj janë ekspozuar në shumë raste, përfshirë edhe ekspozita personale në pavijonin e Republikës së Kosovës në Bienalen e 56-të të Venecias (2015), në mumok, Vjenë (2014) dhe në Galerinë Kombëtare të Arteve të Kosovës, Prishtinë (2014). Në vitin 2016 ka qenë artist rezident në Villa Romana në Firence, dhe në po të njëjtin vit është nderuar me çmimin Ars Viva. Në vitin 2018, ajo është pjesëmarrëse në Artin Publik të Mynihut dhe Bienalen e Busanit.

Opinion i Ditës

Lulzim Basha dhe zjarri (ar)mik

Nga Dr. Albano Zhapaj

(vijon nga faqja 1)

... së Edi Ramës. Çdokush është i aftë të kuptojë se po jetojmë në një vend ku institucionet qendrore e lokale ushtrojnë kontroll në biznes e në popull me anë të frikës, papunësisë dhe varfërisë, ku pasiguria e jetës është rritur dukshëm, ku recesioni ekonomik e shoqëror vjen çdo ditë e më i hidhur, ku sistemi oligarkik qeverisës ka shtrirë metastazat e tij përmes korrupsionit në çdo qelizë të mundshme të shoqërisë shqiptare dhe ku të përpqesh të flasësh me zërin e së vërtetës, etiketoheh si kundërshtar i qeverisë, dashakeqës i Shqipërisë, panikaxhi, dembel apo edhe deri tek i paafët.

Situata e keqe ekonomike, papunësia, varfëria dhe mjerimi vazhdojnë të rriten në proporcion të drejtë me rritjen e çmimeve, taksave dhe shpenzimeve superluks të qeverisë. Shqipëria vazhdon të rënditet si vendi më i korrumpuar në rajon, trafikimi i drogës është në nivele të konkurrueshme me Kolumbinë dhe Afganistanin, kriminaliteti në rritje me vrasje e atentate që tanimë bëhen përballë portës së shtëpisë, ose në sheshet e qyteteve në mënyrë demonstrative, siguria e njerëzve rrjedhimisht ka ardhur duke u përqekësuar nga dita në ditë.

Opozita shqiptare me në krye Lulzim Bashën në këto pesë vjet këtë situatë vazhdimisht e ka denoncuar, e ka kundërshtuar, ka protestuar, diku ka arritur fitore të ndjeshme, kujtojmë ligjin e dekriminalizimit, dhe diku tjetër ka dështuar. Lista e gjatë e skandaleve korruptive e kriminale të kësaj qeverie është padyshim shumë herë më e madhe se lista e betejave të opozitës, humbëse dhe fituese të marra së bashku, por prapë se prapë në perceptimin e shumë shqiptarëve, opozitarë apo jo opozitarë, paudhësitë e keq-qeverisjes çuditërisht shkojnë dhe i "faturohen" kreut të opozitës, Lulzim Basha, i cili në gjykimin tim, ndodhet aktualisht mes drejtimit të luftës opozitare me "zjarrin armik", që i vjen nga qeveria "Rama" dhe "zjarrin mik" që i vjen nga ish-pushtetarë, ish-deputetë apo personazhe, potencialë ose jo, anëtarë të vetë opozitës.

Çfarë kuptojmë me "Zjarrin mik"?

Po të gërmojmë në fjalorin e gjuhëve të Evropës Perëndimore mbi kuptimin e togfjalëshit "Zjarr armik", vështirë se gjejmë një përkufizim të caktuar, alegorik ose jo, pasi bashkëndahet qartazi kuptimi i tij brenda çdo komuniteti apo shoqërie si **goditje që të vijnë nga pala kundërshtarë**, nga armiku, goditje këto qoftë fizike, ashtu edhe të karaktereve të tjera si: ekonomike, politike, mediatike etj.

Ndërkohë, "Zjarrin mik" ka një përkufizim të qartë në zhargonin ushtarak, ku përshtatet një situatë të caktuar në të cilën ushtarët ose automjetet bien pre e zjarrit të



baterive të tyre, ose të aleatëve të tyre. Ushtria amerikane për këtë grupim përdor termin "Friendly Fire" (Zjarrin mik) ose "No-Hostile Fire" (zjarr jo armik).

Një tjetër kuptim i "Zjarrit mik" përfshin gabime identifikimi, të cilat ndodhin kur trupat mike sulmohen gabimisht sepse besohet të jenë armiq. Aksidente apo situata të këtij loji ndodhin nga gabime në drejtimin ushtarak, kur luftimet përfshijnë trupa në lëvizje, ose kur trupat janë shumëkombëshe, gjë e cila rrit gjasat e episodeve të "Zjarrit mik". Kur goditet nga "Zjarrin mik" janë të qëllimshme, atëherë përdoret një tjetër term në anglisht, që e përkufizon situatën si "Fratricida" ose të thënë shqip "vëllavrasje".

Në fusha të tjera të jetës përdorimi i togfjalëshit "Zjarrin mik" merr një sinjifikat alegorik dhe nënkupton goditjet, kritikën apo kundërshtitë që të vijnë nga njerëzit që i përkasin të njëjtit grupim shoqëror apo politik, në të gjitha format e mundshme.

Nga vjen "Zjarrin mik" ndaj Lulzim Bashës?

Është e qartë që kjo mazhorancë dhe shefi i saj do të qeverisë aq gjatë, sa më tepër të jetë e dobët opozita e sa më tepër të jetë nën presionin e "zjarrit armik" kryetari i opozitës. Nëse "Zjarrin armik" dihet qartësisht se nga i vjen Lulzim Bashës, pra nga mazhoranca qeverisëse, nga vetë kreu i qeverisë, si dhe nga çdo element përbërës apo i lidhur me këtë qeveri, duket se forma e dytë e goditjes nga "Zjarrin mik" i vjen nga tjetërkund, nga brenda, nga të vetët.

Ky "zjarr mik", i përkufizuar si më sipër, vjen nga "bateritë" e të njëjtit grupim politik, kryesisht

nga ish-funksionarë të qeverisjes së kaluar dhe në ndonjë rast edhe nga ndonjë aleat. Në rast se në një vend normal demokratik për opozitën përdorimi i fjalës "luftë" është i rrallë, përdoret më tepër në mënyrë alegorike për paralelizëm, pasi ajo shihet si një vëzhguese kritike e qeverisjes dhe një alternativë e ardhshme qeverisëse, në Shqipëri për opozitën përdorimi i fjalës "luftë" është në kuptimin e vërtetë të fjalës, pasi i duhet të luftojë në një qeveri të lidhur me krimin, siç ajo denoncon përditë me fakte.

Në këtë luftë, që pa dyshim mund ta konsiderojmë si luftë e së mirës kundër të keqes, të së drejtës kundër të padrejtës, të arsimimit kundër injorancës, të lirisë kundër robërisë, të mirëgenies kundër varfërisë, të jetesës në vendin tënd kundër emigrimit të detyruar, opozita përbën ushtrinë e vetme shpëtimtare dhe kryetari i saj, gjeneralin që drejton këtë luftë.

"Zjarrin mik" që vjen nga "bateritë" e grupimit të djathtë politik përkundër kryetarit të tij nuk bën gjë tjetër veçse zgjat jetën e (keq)qeverisë dhe çon ujë në interesat personale dhe jo vetëm, të shefit të mazhorancës aktuale dhe oligarkëve që e rrethojnë.

"Zjarrin mik" ndaj Lulzim Bashës, spontan apo i sponsorizuar?

Makinaria gjigante e propagandës qeveritare në këto pesë vjet ia ka dalë me sukses të spostojë vëmendjen e njerëzve të thjeshtë nga problemet reale që ka vendi tek lojërat politike dhe konfliktet e radhës, nga varfëria dhe emigrimi të veshja e kryeministrit, nga vjedhjet galopante me koncesionet PPP tek fajin e ka Basha që nuk

ngrihet, nga dështimet e reformave tek opozita që nxin situatën tek ndërkombëtarët.

Logjikisht edhe pse të vjen të mendosh se kjo makinë propagande proqeveritare funksionon në mënyrë perfekte sepse ka në shërbim të saj persona që janë profesionistë të komunikimit dhe të manipulimit të masave, gjykojmë se kjo s'do të mjaftonte e vetme të jetëgjatësorë pushtetin, pasi njerëzit po e shikojnë se si vendi po boshatiset përditë, se si shkollat po mbyllen se nuk ka fëmijë, se si papunësia po rritet dhe fenomenet kriminale kanë zënë rrënjë. Qeveria është e vetëdijshme që nuk mjafton vetëm ajo të luftojë opozitën dhe i duhet që të gjejë aleatë brenda kundërshtarëve, pra kua! Troje që të punojnë për të.

Racionalja apo "logjika spontane" të bën të mendosh se kur brenda opozitës nuk punohet siç duhet dhe kur nuk drejtohet me efektshmëri, atëherë spontanisht elementë brenda saj gëzojnë të drejtën e kritikës, kundërshtisë apo edhe të "zjarrit mik" përkundër kryetarit të tyre. Përsëri logjikisht duam të pranojmë se kundërshtitë që vijnë nga "zjarrin mik" ndaj Lulzim Bashës të jenë minimalisht në proporcion të drejtë me kritikën dhe denoncimet e tyre përkundër keq-qeverisjes, korrupsionit dhe krimin, por shikojmë që edhe kjo nuk ndodh. Rrjedhimisht kemi të drejtën të mendojmë se ky "zjarr mik" është i orientuar apo edhe i sponsorizuar nga vetë qeveria, njerëzit pranë saj, oligarkia dhe pse jo edhe vetë krimi.

Në një kohë kur Shqipëria është në krizë dhe vendi po rreshket drejt një diktature të re, kur një pjesë e madhe e popullsisë po vuan për shkak të qeverisjes së keqe,

mungesës së sundimit të ligjit, zbatimit selektiv të tij, shkëlqesë të drejtave themelore të njeriut, përqekësimit të skajshëm të gjendjes ekonomike dhe sociale, kur një pjesë e popullatës vazhdon të braktisë shtëpitë, qytetet, fshatrat, miqtë edhe shokët, për t'u drejtuar drejt Perëndimit, për një jetë më të mirë e më të sigurt për fëmijët e tyre, logjika spontane na thotë se adresimi i "zjarrit mik" ndaj Lulzim Bashës dhe jo ndaj qeverisë apo shefit të saj nuk është gjë tjetër veçse një aksion i sponsorizuar i makinës qeverisëse dhe shefit të saj.

Kujt i shërben "zjarrin mik" ndaj shefit të opozitës?

Farkëtarët politikë të "zjarrit (ar)mik" dhe përdoruesit e tij, personazhe të veshur me pushtet në mandatin e qeverisjes së djathtë 2005-2013, ish- ministra, ish-deputetë, ish-drejtuës të lartë institucionesh duhet të dinë se e djathta humbi edhe si pasojë e arrogancës së tyre, si pasojë e injorancës dhe paafetësisë për të bërë shtet, si pasojë e korrupsionit, që me dashje apo pa dashje këta ish-pushtetarë lejonin t'u kalonte pranë syve, saqë edhe qytetarët u lodhën aq shumë duke pranuar një ndryshim të ri, paqka se nuk e dinin se me qeverisjen që votuan do të përjetonin qeverisjen më të keqe që kishin parë ndonjëherë.

Zjarrmëtarët (armiq ndaj shefit të opozitës duhet të kuptojnë se zjarrin i tyre po forcon të keqen, atë të keqe që përfaqëson shumica aktuale sot, e cila ka bërë dhe vazhdon të bëjë gjithçka për ta venitur rolin dhe figurën e opozitës dhe për ta fabrikuar atë, në mënyrë dhe forma aspak dinjtoze, si brenda ashtu dhe jashtë parlamentit.

Zjarrmëtarët (Friendly Fire) duhet të kuptojnë se zjarrin i tyre polodh qytetarët, të cilët janë mëse të rraskapitur nga kjo keq-qeverisje saqë kanë pranuar që varfëria të ulet këmbëkryq në vatrat e tyre në trajtën e një "status quo", ndërkohë që nevojitet një fillim i ri, një erë e re me ndryshime thelbësore në mënyrën se si qeveria vepron me qytetarët, mënyrën se si ajo buxheton paratë e taksapaguesve, mënyrën se si takson dhe rregullon veprimtaritë shoqërore e njerëzore.

Përdoruesit miq të "zjarrit (ar)mik" duhet të kuptojnë se pikërisht në këtë moment, zjarrin i tyre nuk shkon vetëm kundër Lulzim Bashës apo popullit të djathtë, por shkon në dëm të të gjithë shqiptarëve, pasi sot më tepër se kurrë duhet të kuptojnë se forca e një populli për ndryshim, duke i rënë opozitës dhe dalë krahë qeverisë, shkon drejt rreziqesh. Të menduarit e thjeshtë e racional që ka një popull liridashës të nxjerr në konkluzion se në qoftë se "zjarrmëtarët miq" e bëjnë këtë punë qëllimisht e të sponsorizuar, atëherë bëhen palë në rreshtinjen e vendit nën kthetrat e diktaturës dhe si të tillë, "zjarrin i qëllimshëm mik" i tyre nuk mund të kuptohet si "Friendly Fire", por si "Fratricida" e thënë shqip "vëllavrasje".


Opinioni *i* Ditës

Gjithçka për konsumin

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... më të prekur nga reformat dhe tranzicioni tek ne, kjo sasi parash shtesë, edhe pse kaq e vogël, i bën mirë konsumit. Dhe konsumi është gjithçka në një ekonomi që do të rritet. Kërkesa e rritur jep sinjale zemërdhënëse për të gjithë prodhuesit e mallrave dhe shërbimeve tek ne. Ministri i Financave dhe Ekonomisë thotë se është rritur paga mesatare në shtet për vitin e kaluar me 8 përqind dhe ka rritje edhe për këtë vit. Pagat e mjekëve, infermierëve dhe arsimtarëve duhet të ishin situuar me 5 përqind nga 1 korriku i këtij viti. Do të jetë lajm i mirë, po të ketë ndodhur kjo rritje. Megjithatë, të gjitha këto janë pak, fare pak. Qeveria duhet të përqendrojë të gjitha bateritë e saj tek paketa fiskale e vitit që po afron, 2019-ës. Erdhi tetori, muaji që përgatitet draft-Buxheti i Shtetit për vitin e ardhshëm. Për katër vjet rresht, tetor 2014, 2015, 2016 dhe 2017, nuk guxoi të zhbente një veprim tejet të gabuar të ndërmarrë më 1 janar 2014, vendosjen e taksës progresive dhe rritjen e tatimit mbi fitimin me 50 përqind. Taksa progresive mbi të ardhurat personale goditi drejt për së drejti shtresën e mesme tek ne. Shumë mund të mendojnë se konsumi në një vend diktohet nga harxhimet marramendëse të milionerëve dhe miliardërëve të tij. Tek ne, ata që zotërojnë qindra mijëra euro apo disa miliona euro. Kjo nuk është e vërtetë. Konsumi bazohet mbi kërkesën e shtresës së mesme. Kjo shtresë ka mbi katër vjet që qëndron kështu, e goditur. Dhe konsumi në Shqipëri e ka ndërjerë fort. Në rast se qeveria arrin të jetë aq kurajoze sa të flakë tej dogmën dhe doktrën populiste se sistemi tatimor progresiv solli një trajtim të drejtë të atyre me të ardhura më të pakta, dhe t'i kthehet ndihmës reale ndaj konsumit, atëherë do ta ndihmojë ekonominë e këtij vendi. Nuk ka asnjë drejtësi apo padrejtësi në një sistem tatimor. Një taksë mund të jetë e tepërt, e madhe, efektive ose e pamundur për t'u vjelë, por jo e drejtë apo e padrejtë. Ky sistem fiskal kështu si është sot ka dëmtuar aftësinë konsumatore të shtresës së mesme shqiptare, që dikton konsumin në vend. Prandaj dhe qeveria ka tri



veprime shumë të thjeshta, por për të cilat duhet shumë zemër, që të bëjë në paraqitjen e draft-Buxhetit të Shtetit në fund të tetorit 2018. Pa u prapsur tërësisht nga sistemi progresiv për të mos humbur pikë politike, së pari, të deklarojë rritje rrogash të buxhetorëve me 5 përqind për vitin 2019, si dhe të pënsonëve të të gjitha kategorive po

me 5 përqind. Kjo do t'i jepte një impuls të fuqishëm ekonomisë, besim konsumatorëve dhe sipërmarrësve, si dhe optimizëm tregut. Së dyti, të ulë tatimin mbi fitimin nga 15 në 10 përqind, sa ishte deri më 31 dhjetor 2013. Kjo do të sillte një rritje të fortë të investimeve të huaja dhe të vetë biznesit vendas, rritje e cila mund t'i sjellë një qev-

erie kurajoze edhe 120 milionë euro të ardhura nga taksat për vitin e ardhshëm. Së treti, të zërojë tatimin për fitimin për sektorin e prodhuesve me material porositi (fasonistët) për një periudhë 3-5 vjet. Brenda të njëjtës kohë, sektori i ka të gjitha shanset të dyfishojë investimet dhe vendet e punës, duke punësuar edhe 60 mijë vetë më shumë për periudhën 2019-2021. Të ardhurat e munguara në Buxhet nga zerimi i taksës mbi fitimin për fasonistët do të ishin vetëm 7.5 milionë euro! Nuk do t'ia viente një provë e tillë për të shtuar kapacitetet prodhuese dhe ato eksportuese të vendit? Por pyetja me vlerë një milion dollarë është: A do të guxojë kjo qeveri? Gjithçka varet nga vizioni dhe kuraja e atij që ka timonin dhe e atyre që e këshillojnë për ekonominë. Një gjë është e vërtetë absolute: nëse ndihmohet me çdo mënyrë konsumi i shqiptarëve sot, ndihmohet edhe ekonomia e gjithsecilit prej nesh.

Në rast se qeveria arrin të jetë aq kurajoze sa të flakë tej dogmën dhe doktrën populiste se sistemi tatimor progresiv solli një trajtim të drejtë të atyre me të ardhura më të pakta, dhe t'i kthehet ndihmës reale ndaj konsumit, atëherë do ta ndihmojë ekonominë e këtij vendi. Nuk ka asnjë drejtësi apo padrejtësi në një sistem tatimor. Një taksë mund të jetë e tepërt, e madhe, efektive ose e pamundur për t'u vjelë, por jo e drejtë apo e padrejtë.

HOROSKOPI

- DASHI**
Ankthi juaj do të zhduket ndërsa merrni nën kontroll situatën. Duhet të mësoni disa leksione nga disfatat tuaja të kaluara në punë. Sot do të merrni shumë ftesa interesante, si dhe një dhuratë surprizë.
- DEMI**
Shprehuni mirënjohjen tuaj ndaj të afërmeve që ju kanë ndihmuar në kohë krize. Gjesti juaj i vogël do t'i lumturonte këta persona. Sot partneri juaj do ta ketë tejet të vështirë për t'u marrë me sjelljen tuaj të çrregullt.
- BINJAKET**
Mos lejoni që t'ju kapë ndjenja e zhgënjimit. Pas një kohe të gjatë, ju dhe partneri juaj do të kaloni një ditë të qetë së bashku, pa luftime dhe argumente. Mendojeni dy herë përpara se të bëni një blerje.
- GAFORJA**
Shanset për t'u shëruar nga problemet fizike janë të larta, gjë që do t'ju mundësojë të merrni pjesë në aktivitete sportive. Problemet në vendin e punës mund t'i dërgoni në shtëpi.
- LUANI**
Duhet të uleni dhe të qetësoheni, si dhe të përfshihen në aktivitete që ju kthejnë humorin. Një takim i papritur romantik është parashikuar sot. Shefi juaj nuk do të jetë i interesuar për justifikime, ndaj bëjeni sa më mirë punën.
- VIRGJERESHA**
Shmangni alkoolin e tepërt dhe ngarjen me nxitim të makinës. Ju do të prezantoheni me shumë skema të reja financiare, por peshoni me kujdes çdo vendim që ndërmerrni.
- PESHORJA**
Mos humbni kohë duke ndërtuar kështjella prej rëre. Aftësia juaj për t'u bërë përshtypje të tjerëve do të sjellë shpërblime. Armiqtë në punë mund të bëhen miq me ju sot vetëm për shkak të një akti të vetëm të mirë.
- AKREPI**
Ka të ngjarë të përballeni me disa pengesa. Mos e humbni kurajën, por punoni më shumë për të marrë rezultatet e dëshiruara. Do të jetë një ditë e mahnitshme në jetën tuaj të dashurisë.
- SHIGJETARI**
Mos u sillni si ata njerëz që heqin dorë nga shtëpia dhe shëndeti për të realizuar ëndrrat dhe për të ndjekur pasionet e tyre. Bëni kujdes me buxhetin tuaj për të shmangur problemet financiare.
- BRICJAPI**
Bashkëpunoni më një koleg, sepse ndihma e tij do të jetë shumë e vyer. Ka ardhur koha që të mos bëni përjashtime sa i përket shoqërisë suaj. Megjithatë, mos e zgjeroni shumë rrethin e të njohurve.
- UJORI**
Përpjekjet e bëra për të përmirësuar pamjen dhe personalitetin tuaj do të kthehen në kënaqësinë tuaj. Në vendin e punës do ju shikojnë me admirim pikërisht për shkëlqimin që rrethon.
- PESHQIT**
Shmangni një person egoist sot, pasi ai mund t'ju shkaktojë shumë tension. Nuk është një ditë shumë e dobishme, prandaj kontrolloni situatën tuaj financiare dhe kufizoni shpenzimet. Mos e neglizhoni jetën tuaj shoqërore.

MESFUSHORI SQAROHET

Robert Snodgras është një nga lojtarët që i është shtuar listës së Skocisë për ndeshjet e radhës me Belgjikën dhe Shqipërinë. Trajneri i skocezëve, Aleks Meksleish, e grumbulloi atë pas dëmtimit të Mat Filipis. Lojtari i Uest Hamit ka folur së fundi në lidhje me pozicionin e tij, duke sqaruar se nuk ishte angazhuar më parë me kombëtaren e Skocisë, për shkak të një problemi shëndetësor të nënës së tij. "Herën e fundit që isha në skuadër, nëna ime ishte në spital dhe më pas kam dashur të jem pranë saj. I kisha thënë trajnerit të mëparshëm, Gordon Straçan, për këtë problem. Më shqetësonte shëndeti i nënës



Robert Snodgras: Kurrë nuk ia kthej shpinën Skocisë

time, edhe pse kam dashur të luaj. Ka qenë një situatë shumë e vështirë për mua. Fola me trajnerin dhe ai më tha se më donte në skuadër", - ka thënë Snodgras, i aktivizuar me shumë skuadra në Angli. Trajneri i Skocisë ishte

munduar ta shpjegonte mungesën e këtij lojtari te Skocia, por ka pasur edhe keqkuptime. Vetë Snodgras ka theksuar se kurrë nuk dëshiron që t'i kthejë shpinën Skocisë. "Trajneri gjithmonë përpiqet t'i mbrojë lojtarët e tij dhe këtë

vlerësoj. Ai është treguar i shkëlqyeshëm me mua, gjithmonë më ka dashur në skuadër. Kam folur me familjarët e mi dhe ata më kanë këshilluar të luaj. Fjalët e trajnerit më parë janë keqkuptime. Ai nuk ka folur për mentalitetin tim, por për gjendjen që po kaloja për shkak të shëndetit të nënës", - ka shtuar futbollisti 30-vjeçar i Skocisë, që më 10 shtator do të presë Shqipërinë.

Shkodrani në fillim kërkon të mbrojtë pastaj të ndihmojë sulmin

TANI DUHEN GOLAT



Tirana prezanton Namdo Oduamadin

Sulmuesi afrikan, Namdo Oduamadi, është prezantuar te skuadra e Tiranës, duke bërë fotot e rastit në ambientet e klubit. Me ardhjen e këtij lojtari, drejtuesit e Tiranës shpresojnë shumë të kenë zgjidhur problemin e golit, pasi në tri javë kanë shënuar vetëm një gol. Klubi bardheblu ka postuar edhe fotot e prezantimit të sulmuesit në faqen zyrtare. Trajneri Ze Maria ka mundësi ta shohë më mirë gjendjen e këtij lojtari, pasi ka më shumë kohë për ndeshjen e radhës me Luftëtarin. Oduamadi ka luajtur sezonin e fundit te Helsinki në Finlandë, ndërkohë që kartonin e tij e ka pasur më parë Milani.

Hysaj: S'vij në Kombëtare për të kaluar kohën!

Mbrojtësi i Napolit i përgjigjet Igli Tares

Jeton Selimi

E lseid Hysaj nuk ka ngurruar t'i përgjigjet Igli Tares, i cili pak kohë më parë ishte shprehur se pret ende të shohë mbrojtësin të luajë me Shqipërinë po aq mirë sa luan me klubin e tij. Në konferencën e djeshme për shtyp, mbrojtësi kuqezi i është përgjigjur ish-sulmuesit të përfaqësueses, duke theksuar se nuk vjen për qejf të kuqezinjte, por për të dhënë kontributin e tij.

LIDER
"Jam shumë i kënaqur me fillimin e kampionatit, kam luajtur rregullisht, edhe trajneri është i kënaqur. Cana më quan lider? Nuk e mendoj tani shiritin, kam qenë shumë i lumtur në Europian kur më vuri ai shiritin në krah, ishte ndjesi e veçantë, sepse dihet se kush është ai. Ndihem shumë mirë, bëj punën time dhe jam gati për ekipin kombëtar, shiritin pastaj ta shohim me kokë".

MUNGESAT
"Sadiku apo Roshi janë mungesa të mëdha, por ne jemi një grup shumë i mirë, gjendemi mirë bashkë. Tani që u kthyen disa lojtarë me eksperiencë, po krijojmë një grup më të mirë, më të bashkuar dhe bëhemi gati për ndeshjet."

NDRYSHIMET
"Ky ekip ka ndryshuar komplet që në ndeshjet e verës, të cilat ishin shumë keq. Atëherë ishin shumë faktorë, si pushimet, lojtarët të lodhur, kishim shumë probleme. Do t'i harrojmë ato ndeshje se me entuziazmin që kanë ardhur lojtarët do të jetë shumë më mirë në këto dy ndeshje të radhës".

GATISHMËRIA
"Te Kombëtarja kanë qenë gati gjithmonë, edhe pse shumë lojtarë kanë pasur pak minuta në këmbë. Por me karakterin e zemrën që kemi në shqiptarët, do të bëjmë maksimumin në fushë".

IZRAELI
"Besoj që duhet të jemi të qetë, të mos mendojmi te e kaluara, të fokusohemi në këto ndeshje se është mundësi që na jepet për të shkuar në Europian. Besoj se janë ndeshje të barabarta, jemi gati, jemi duke u stërvitur



mirë. Të gjithë e kanë kuptuar që janë ndeshje reale, jo miqësore, se na afrojnë shumë me kualifikimin. Duhet që të mos i falim minuta, si i kemi falur në Shqipëri.

Siç e pamë në të dy ndeshjet, kemi mundësi të luajmë dhe të fitojmë me Izraelin, e kemi parë se edhe me 10 lojtarë nuk e kishin të thjeshtë të luanin kundër nesh, thjesht

duhet të jemi të përqendruar, të fitojmë ndeshjen".

PANUÇI
"Tani kemi një trajneri të ri, disa mendime të reja të lojës, se të gjithë jemi duke u

mësuar prej një viti me trajnerin dhe idetë e tij. Kemi marrë gjithë gabimet dhe vërejtjet për t'i rregulluar, do të jemi gati për këtë ndeshje".

DETYRAT
"Unë do bëj punën që kërkon trajneri, të jem më para tregoj aftësitë sulmuese. Por duhet të kemi një gjë në tru, që të luajmë duke menduar për Europianin se kualifikimi përsëri do të ishte një gjë më e madhe. Këtë vit kemi ardhur me entuziazëm më të madh për ta arritur".

KRITIKAT
"Këtë punë kanë, por unë besoj se kur mbaroj lojën e dal jashtë, jam i qetë me veten time. Çfarë thonë njerëzit pastaj nuk më intereson, kam jetën time, lojën time. Unë këtu vij se dua t'i jap një dorë vendit tim, jo për të kaluar kohën se mund ta kaloja në vend tjetër. Vij me qejf për të dhënë maksimumin gjithmonë".

Prezantohet trajneri i ri

Klodian Duro: Kamza, përgjegjësi e madhe




Trajneri i ri i Kamzës, Klodian Duro tha për mediet se me skuadrën e tij të re synon që të prodhojë futboll të bukur, të marrë rezultate pozitive dhe pse jo, të arrijë dhe një vend në Evropë. Ish-trajneri i Kukësit tha se ky kampionat është shumë i vështirë dhe gabimet nuk mund të pranojnë. "Për mua është një përgjegjësi e madhe të jem trajner i Kamzës. Superliga shqiptare është një kampionat shumë i fortë. Këtë gjë e ka treguar kampionati e fundit, po e tregojnë dhe këta javë të para. Unë do të bëj maksimi-

mumin për të arritur të gjitha objektivat. Pse jo, të shkojmë dhe në pjesën e sipërme të tabelës. Tashmë rrugët janë të hapura për të gjitha skuadrat shqiptare, prandaj dhe ne mund të synojmë që të kapim një vend në Europë". Shkarkimi i Devollit: "Nuk është se ndihem mirë kur një trajner largohet që në javën e tretë, por unë e thashë dhe më parë se ky kampionat është shumë i fortë dhe gabimet janë të vështira për t'u

pranuar. Duhet vënë bazat sa më shpejt, të ndërtojmë një skuadër që bën futboll dhe merr rezultate, në mënyrë që të kemi vazhdimin sa më të lehtë. Çdo trajner ka idetë e veta dhe unë dua që skuadra ime të luajë një futboll me logjikë, një futboll me zotërimin e topit dhe falë zotërimit, të gjejmë dhe rrugën e rrjetës. Në fund, është goli ai që vendos rezultatin dhe numrin e pikëve në tabelë. Unë mendoj se hap pas hapi, duke i marrë gjërat seriozisht, gjithçka pozitive do të vijë", përfundoi fjalën e tij Duro.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Të parat në stadium.
- 2. Lihet një me orar.
- 6. Një sferë për model.
- 10. I vocërr ai i Migjenit.
- 11. Një tregu është në kapitalizëm.
- 14. Eshhtë nofka.
- 16. Rastet pa set.
- 17. Gjysmë zanati.
- 18. Mund të jenë sigurie.
- 19. Eshhtë ekipi që diskuton trofeun.
- 21. Nuk i tregohen babet.
- 22. Ndizen për dinamitin.
- 23. Gjysmë tatimi.
- 24. Janë pushkë.
- 26. Paguhen për vonesa.
- 27. Një tip për të kërcyer.
- 29. Bëhet një duke pranuar.
- 31. Pak latinisht.
- 32. Fund dhjetori.

- 33. Eshhtë perëmr për gruan.
- 34. Skuadër greke.
- 37. Një verë në Paris.
- 38. Ishin shoqëruesit e Panit.
- 40. Një mund të jetë grosist.
- 43. Luan derby me Liverpool.
- 45. Nuk shihet në një të tillë.
- 46. Vrapojnë në pistë.
- 47. E famshmjia Curie.

VERTIKAL

- 1. Studiohen nga heraldika.
- 2. Janë veshje sportive.
- 3. Një vegël.
- 4. Carson i fumetti-t.
- 5. I takojnë fituesit.
- 6. Kështu janë regjimet despotike.
- 7. Ndezur në aparaturë.
- 8. Kush i forcon ka stabilitet.
- 9. Një lëvizje mashtruese.
- 10. Janë pemë që prodhojnë lende.
- 12. Një antropofag.
- 13. Gjysma e maskës.
- 15. Eshhtë sëmundje diktatorësh.
- 19. Eshhtë zhdukur e nuk bëhet i gjallë.
- 20. Luajnë pa ujë.
- 22. Pak familjare.
- 24. Janë kabina detarësh.
- 25. Kreshniku u voleybollit.
- 26. Kalimi në kufij.
- 28. Emri i Cardin.
- 29. Ishte Aliu i Tepelenës.
- 30. Një luksos me 5 yje.
- 35. Rrjedh një në klepsidër.
- 36. Gjysmë stolie.
- 37. Janë baballarët.
- 39. Nivel pa ekstreme.
- 41. Ruan në kufij.
- 42. Janë tek në gatra.
- 44. Kufizojnë trotuarët.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Një biçikletë dyshe.
- 7. Pak misterioze.
- 10. Bel i Maupassant.
- 12. Eshhtë avantazh i yni.
- 13. Eshhtë i lirë kur është vakant.
- 15. I fundit është mbi të gjithë.
- 16. Një mund të jetë i integruar.
- 17. Fillojnë ofensivën.
- 19. Janë adashët.
- 22. Janë në guvë.
- 24. Eshhtë kardinal.
- 25. Tutori pa uri.
- 27. Eshhtë kisha e papës.
- 29. Lindsay aktore.
- 31. Thahen me bonifikim.
- 32. Shkruhet në janar.
- 33. Hapen me editorial.
- 35. Pak enigmatike.
- 36. Rrjetë në tenis.

VERTIKAL


- 1. Një fjalë si rrallë, aty këtu.
- 2. Një pjesë e aparaturës.
- 3. Një peshë e pastër.
- 4. Gjysma e Drinit.
- 5. Në fund të pritjes.
- 6. I përkasin pakicës kombëtare.
- 8. Ishte car i tmerrshëm.
- 9. Eshhtë si telefilm.
- 10. Inicialet e Daudet.
- 11. Parashtesa e musikult.
- 14. Ndërmarrje Kombëtare Mat.
- 16. Nuk mund të lenë dot mjekër.
- 18. Eshhtë ndenjëse që trashëgohet.
- 19. Janë mashtrime loje.
- 20. Janë gjuhahet.
- 21. Hawke aktor.
- 23. Janë vendet e pazëna.
- 24. Janë greminja.
- 26. Janë sektet islamike.
- 28. Vrau Minotaurin.
- 30. Janë veprat si Vejusha gazmore.
- 34. Qeliza e jetës.
- 38. Kalohet në gjurmë.
- 39. Një sëmundje veshësh.
- 40. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 41. Gjysma e ekipit.
- 43. Pak nervozizëm.
- 44. Një pjesë e titullarëve.
- 46. Inicialet e Delon.
- 47. Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	9		3					8	
	1		5	2					
			7				6	3	1
		5	2	6		1	9		
	3		9		4		7		
	4	2		5	1	8			
4	5	3					7		
				7	8			1	
8				5			2	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

Argëtim filozofik

- Çdo zgjidhje duket e parëndësishme për atë që nuk e kupton problemin.
- Problemi me martesën është se biem në dashuri me një personalitet, dhe duhet të jetojmë me një karakter.
- E gjithë kjo pasuri mund largojë vetëm një të keqe: varfërinë.
- Shohim shqiponjat të fluturojnë lart, ndërsa delet mbliohen në tufë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

C	1	9	10	5	16	4	11	6	1	10	S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T	
A	6	10	5	9	1	11	4	8	3	9	A	R	M	I	K	E	S	T	O	L	I	T	E
K	5	8	1	1	7	14	3	7	8	3	L	I	O	R	O	M	I	N	A	T	L	A	
L	5	7	10	1	16	2	1	13	1	13	L	O	C	A	B	A	R	E	T	E	L	A	
4	13	15	5	7	11	3	6	4	5	13	A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R		
1	15	1	12	2	4	9	1	14	1	14	T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E	
14	4	8	2	3	2	18	7	1	1	7	A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T	
10	7	2	3	1	7	7	18	2	3	3	A	R	S	E	N	E	A	A					
3	7	11	1	2	7	18	12	6	6	6	A	D	A	T	M	E	T	R	I	A	C		
13	4	4	3	6	3	14	1	2	4	4	P	A	K	T	P	I	R	A	T	E	R	I	
14	3	11	3	7	1	2	16	3	7	12	K	U	A	L	I	T	E	T	I	E	P		
3	13	4	9	3	6	4	3	4	13	2	L	E	C	E	P	I	N	A	T	A			

Thënie të mençura

- Askush nuk është i kënaqur me fatin e tij, edhe nëse ai është i mirë. Dhe askush nuk është i pakënaqur nga mendja e tij, edhe nëse është më e keqja.
- Optimist është një njeri që sheh dritë atje ku nuk ka.
- Pesimist është budallai i cili përpiqet ta shuajë.
- Veprimi nuk buron nga mendimi, por nga gatishmëria për përgjegjësi.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

F	E	R	M	A	N	I	T	J	N	A		
A	K	S	I	L	O	V	A	L	E			
R	O	N	E	P	F	R	E	N	A	T		
A	H	I	P	O	K	R	I	T	E	T		
D	E	M	O	S	T	E	N	I	I	K	E	
D	I	K	A	S	T	E	R	E	T	N	O	R
A	M	A	L	I	A	I	Z	E	N	E	A	
D	E	L	E	R	A	E	O	E				
A	R	I	E	P	I	T	E	T	E	T	E	
I	G	O	M	A	I	D	M	A	D	H	I	
S	R	I	K	E	L	L	E	R	E	N		
T	E	R	R	O	R	I	A	K	E	N	A	T
F	U	I	S	S	P	A	M	A	L	I	A	
A	L	K	T	R	O	B	E	R	I	A		
P	P	E	R	I	O	D	I	K	B	N	A	
F	I	N	A	L	J	A	A	A	R	N		
R	E	P	A	R	T	E	T	N	S	I	A	
T	E	R	E	K	S	I	P	N				
P	A	R	E	T	R	E	K	E	T	I		
A	R	I	T	R	E	A	L	K	U	P	A	
S	F	E	I	T	I	M	E	T				
T	A	N	D	E	M	N	E	R	E	U	R	
A	H	O	T	E	L	E	T	T	R	A	U	
J	U	K	A	T	E	R			A	R	M	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

